

85H-32

K 50



SKIFTER KËLLIÇI

...ne tokë
të huaj

NOVELË

891.983-32

S

K 50

SKIPTER KËLLIÇI

R

...NË TOKË TË HUAJ

(Novelë)

35780

49961

LIBRARI E SHKOLLËS
DURRËS

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

KAPITULLI I

NË TOKË TË HUAJ

Radiokronisti sportiv ndoshta do ta kish mbyllur manjetofonin dhe do të kishte ikur. Ai kishte rreth dy orë që priste në sallën e madhe të pritjes, nga ku përmes dritareve të mëdha, aeroporti çfaqej me tërë gjerësinë e tij.

Salla e pritjes kish filluar të boshatisej. Ata që kishin arritur me aeroplan mbas udhëtimesh të lodhshme, kishin pushuar ca, kishin pirë gjësendi, pastaj ishin nisur.

Midis tyre kishte patur dhe ekipe sportive të vajzave, që do të merrnin pjesë në krosin ndërkombëtar. Radiokronisti sportiv pikërisht për këtë qëllim kishte ardhur. Në shiritin e kuqërremtë të manjetofonit, së bashku me zhurmat e aeroportit, që krijonin një ambient të gjallë për radiokronikën e tij, kish regjistruar dhe përshtypjet e tij nga arritja e ekipeve sportive dhe, ajo që kishte më tepër rëndësi, kish regjistruar dhe intervistat e para. Zakonisht ato i bënin gjithmonë tërheqëse radiokronikat, sepse në fund të fundit ishin ato që do të ngjallnin kureshtjen e dëgjonjësve të emisio-neve të mbrëmjes.

Ishte i bindur se këtë radiokronikë e kishte përgatitur mirë, po ndoshta nuk e kish aq të plotë. Atij i kishte bërë përshtypje një nga ekipet sportive, që kishte kaluar papritur e pakujtuar para tij, kur po intervistonte pjesëtarët e ekipit që pat arritur i pari në aeroport. Ekipi përbëhej, veç të tjetërsh, nga treneri, një burrë i gjatë me flokë të kuqërremtë, i veshur me kostum të errët, që nxirrte më tepër në pah ngjyrën e flokëve të tij, nga një burrë tjetër, i hollë e i gjatë, me flokë pakëz të rënë, që nga mënyra si ecte, fliste e si vështronte, i ngjante më tepër një gazetari, dhe nga tri vajza që patjetër duhet të ishin pjesëtarët e delegacionit. Radiokronistit i kishte bërë përshtypje midis tyre një vajzë shtathedhur, me flokë të verdhë të prerë shkurt, që dukej tepër e gjallë dhe e shpenguar. Madje atij i qe dukur se të tëra ato dukeshin të gjalla dhe të shpenguara. Nga mënyra se si ecnin, si flisnin, nga gjestet e tyre, radiokronistit i qe krijuar bindja se ai ekip kishte ardhur i bindur se do ta fitonte vendin e parë në krosin ndërkombëtar. Ai kishte dashur t'i intervistonte pjesëtarët e delegacionit sportiv, po nuk kishte mundur, sepse ata nuk kishin qendruar në sallën e pritjes.

Megjithatë, radiokronisti sportiv nuk shqetësohej. Pas disa ditësh, në prak të fillimit të krosit ndërkombëtar, do të përgatiste një radiokronikë tjetër. Atëhere do të mund t'i intervistonte.

Kështu pra, si mund ta kishte mbyllur manjeto fonin në ato çaste, kur po sillte ndërmend gjithçka, që kishte parë e regjistruar në aeroport gjatë atyre dy orëve, duke pritur të arrinin ekipet sportive, megjithatë, vendosi të presë dhe ca. Atij i

patën thënë se atë ditë mund të vinin të gjitha ekipet pjesëmarrëse. Megjithëse nuk kishte shumë rëndësi, ishte i interesuar ta dinte edhe këtë. Këtë fakt do ta shtonte pastaj në fund të radiokronikës së tij.

Duke kundruar, ashtu ndenjur në një nga kolltukët e sallës së pritjes, atij ju duk se aeroporti i ngjante një shkretëtire. Nga sheshi i gjerë, i betonuar, që, nën rrezet e përzhitura të diellit të nxehtë të qershorit, kishte marrë një ngjyrë të verdhë, ngriheshin avuj të nxehtë. Pas tyre, konkretet e godinave të tjera të aeroportit, kodrat e gjelbëruara, që shtriheshin tutje, dridheshin e ndrydheshin sikur të ishin të vizatuara në një pëlhurë, që valavitet nga era.

«Shkretëtirë e vërtetë», mendoi radiokronisti sportiv. «Dhe, midis kësaj shkretëtire, një oaz».

As vetë nuk e kuptoi përse e përkufizoi në këtë mënyrë aeroportin, ndoshta sepse disa nga aeroplanët, që mbuloheshin nga hiet gjigante të fasadave të godinave të larta, u ngjisnin deveve.

Mbase ai do të kishte humbur në pamjet që i ndillte fantazia e tij e hazdisur, sikur befas të mos kish dëgjuar uturimën e një aeroplani.

Ngriti sytë dhe në qiellin e kaltër dalloj një pikë të zezë që sa vinte e zmadhohej. Duke vajtur me mendje se aeroplani po sillte delegacione të tjera sportive, u ngrit.

Aeroplani, pasi bëri një rrotullim rreth aeroportit, filloi të ulej si një zog vigan, i hirtë, me krahë të ngrirë.

S'kaluan pak minuta dhe nga ai filluan të zbresin udhëtarët.

Radiokronisti sportiv nuk kishte gabuar. Po

arrinin ekipet e tjera sportive. Ndoshta këto qenë të fundit. Midis udhëtarëve dalloj dhe tri vajza me kostume të lehta në ngjyrë të kaltër. I njohu nga stemat e kuqe, që dukeshin nga larg në xhaketat e kostumeve; ishin shqiptare. Ai kishte harruar se në krosin ndërkombëtar do të merrnin pjesë edhe vajza shqiptare. Së bashku me to ishte treneri i tyre dhe pjesëtarë të tjerë të delegacionit shqiptar.

Pa humbur kohë, radiokronisti sportiv shtypi pulsantin e manjetofonit. Ai mbante mend fare mirë fjalët që kishte regjistruar në pjesën e fundit të shiritit të manjetofonit: «Vazhdojnë të arrijnë kështu ekipet pjesëmarrëse të krosit ndërkombëtar. S'do të kalojnë veçse pak ditë dhe vëmendja e opinionit tonë sportiv do të përqendrohet te ky aktivitet i rëndësishëm».

Dhe ja tani, duke përqendruar vëmendjen te vajzat shqiptare, nisi të thotë:

«Duke mbyllur radiokronikën tonë të shkurtër, shtojmë se, krahas me ekipet e tjera pjesëmarrëse të krosit, arriti dhe ekipi i vajzave shqiptare».

Ai desh ta intrigojë finalen e radiokronikës, ta bëjë pak enigmatike për dëgjonjësit, ndaj, pa humbur kohë, vazhdoi:

«Çfarë mund t'ju them për këtë ekip? Pothuaj asgjë. Ai është i ri në arenën ndërkombëtare dhe do të marrë pjesë për herë të parë në këtë kros ndërkombëtar».

Parashikimet i kishte qejf. Diç desh të shtojë në ato çaste. Ndoshta të përcaktonte dhe rezultatin e ekipit shqiptar. Megjithatë hoqi dorë nga ky mendim dhe u mjaftua me ato që tha.

Vajzat shqiptare dhe vajzat e ekipeve të tjera po ecnin në pistën e aerodromit.

Radiokronisti sportiv e quajti detyrën e tij të përfunduar, ndaj, pa humbur kohë, mbylli manjeto fonin dhe doli nga salla e pritjes.

Traineri, vajzat shqiptare, si dhe pjesëtarët e tjerë të delegacionit, të prirë nga një shoqëronjës, nuk u ndalën në sallën e pritjes, megjithëse vajzat dukeshin të lodhura. Ato udhëtonin për herë të parë me aeroplan dhe, ndonëse fluturimi nuk kishte qenë i gjatë, prapëseprapë i kish shqetësuar.

Ato ecnin të heshtura prapa trainerit. Duke e kuptuar lodhjen e tyre, ai ktheu kokën dhe u tha duke buzëqeshur:

— Si e ndjeni veten?

— Tani më mirë, — foli Albana, një vajzë fytyrërrumbullaktë, me sy të kaltër. — Edhe këtu bëka mxehtë! Ç'thua ti, Lizë?

— Ke të drejtë, — u përgjegj Liza, duke hedhur pas flokët e zinj, që i mbulonin ballin.

Vajza tjetër nuk tha asnjë fjalë. Ndonëse nuk kishte pësuar asgjë gjatë udhëtimit, ajo dukej shumë e kapitur dhe fytyra i kishte marrë një ngjyrë pakëz të zbetë.

— Ç'pate kështu, Besa? — e pyeti traineri.

— Po më dhëmb ca koka e po më merren mëntë, — u përgjegj Besa.

— S'ka gjë, do të kalojë. Kjo vjen dhe nga ndryshimi i ambientit.

— Sa të arrijmë në hotel e të shlodhemi pak, moj zemër, ke për ta parë sa shpejt do të bëhesh qiçër, — tha Liza dhe së bashku me Albanën e morën për krahu shoqen e tyre.

Vajzat me trainerin kaluan përmes sallës së pritjes, zbritën shkallët e daljes dhe u futën në autobus.

Pjesën më të madhe të rrugës, derisa arritën në hotel, vajzat e kaluan në heshtje. Fare pak folën për ato që u bënëin përshtypje, duke parë rrugët plot zhurmë të qytetit të huaj. Gjatë kohës që autobuzi çante përpara, vajzat kujtonin çastet e ndarjes, atje në aeroportin e kryeqytetit, me prindërit, të afërmit e shokët e shoqet e tyre, fjalët e tyre të ngrohta:

«Dalçi faqebardhë!»

«Na nderofshi!»

«Nderofshi veten tuaj dhe atdheun!»

Duke i parë të zhytura në mendime, treneri nuk u foli.

«Ato kanë nevojë të shlodhen mirë», — mendoi.

Në autobus udhëtonin dhe disa ekiye të tjera. Ai shikonte profilet e vajzave të huaja, që diç bisedonin njëra me tjetrën dhe mendohej t'i përfytyronte në fushën e krosit.

Do të kalonin disa ditë dhe Albana, Liza dhe Besa do të ndodheshin jo vetëm përballë tyre, po edhe përballë vajzave të tjera, që ato nuk i njihnin, ashtu siç nuk njihnin edhe kundërshtarët që po udhëtonin me to e që bisedonin në gjuhë të huaja.

Autobuzi bëri një kthesë nga e djathta dhe u ndal përpara një ndërtese të bardhë. Kishin arritur në hotel.

KAPITULLI II

MISTER BILLEJBERGU

Një njeri ngjiti me nxitim shkallët e hotelit dhe u fut në holl¹⁾. Ndonëse qe bërë natë, ai mban-te një palë syza të zeza. Hodhi një vështrim rreth dhe, siç duket, u habit kur pa që hollu qe i shkretë, sepse mblodhi buzët dhe u kthye rreth e rrotull.

Ishte një burrë rreth dyzet vjetëve, me fytyrë të mbushur dhe i mbajtur mirë. Si ktheu nja dy herë kokën herë majtas, herë djathtas, u drejtua nga hyrja e hotelit, i ndjekur nga vështrimi i portierit, që nuk ja ndante sytë.

— Me ju bisedova një orë më parë në telefon? — pyeti ai anglisht.

— Mos jeni mister Billejbërgu? — ja ktheu portieri, pa ju përgjegjur pyetjes së tij, duke folur edhe ai anglisht.

— Po...

— Siurdhëron, mister Billejbërg. Dhoma juaj është siguruar. Është në katin e pestë, Nr. 233. Doni ta shihni?

— Patjetër.

1) Hyrje, koridori i madh i hotelit.

— Urdhëroni çelësin.

Mister Bllejbërgu mori çelësin, pagoi dhe u bë gati të ngjitej në asensor, mirëpo papritur ndaloi dhe u kthye nga portieri.

— Dëgjova sikur në hotelin tuaj kanë zënë vend dhe sportistë, — foli ai.

— Po. Zakonisht sportistët e huaj zënë vend në hotelin tonë.

— Në mos gaboj, janë ekpie vajzash, që do të marrin pjesë në një kros ndërkombëtar.

— Pikërisht ashtu.

— Nuk po i shoh. Mos janë duke ngrënë?

— Ato sapo hangrën dhe tani janë ngjitur nëpër dhomat e tyre.

— Kaq shpejt?

— Eh, si t'ju them, nuk është dhe kaq shpejt, po të marrim parasysh se ato janë vajza të reja, pastaj sportiste dhe, si të tilla, ato kanë një regjim të rregullt ditor. Po, më falni, mos doni të takoheni me pjesëtarët e ndonjë delegacioni? Po që kështu, unë mund t'ju ndihmoj.

— O, jo, jo unë pyeta kot. Më bëri kureshtar një radiokronikë, ku flitej për ekipet që do të marrin pjesë në këtë kros ndërkombëtar. A do të vinë dhe ekipe të tjera?

— Nuk ma merr mendja. Më duket se të gjitha ekipet arritën.

— Të gjitha në këtë hotel kanë zënë vend?

— Të gjitha. Siç ju thashë, hoteli ynë është shumë i preferuar nga sportistët.

— Nga sa dëgjova në radio, ka edhe ekipe që nuk janë shumë të njohura në arenën ndërkombëtare, — shtoi pastaj mister Bllejbërgu. — Po nuk jam në gjendje të kuptoj se për kë është fjala.

— Po, ashtu është; ka dhe ekipe të tilla. Përshembull ai i vajzave shqiptare — u përgjegj portieri.

— Po, më kujtohet.

— Janë vajza fare të reja. I pashë kur erdhën. Shoqëroheshin nga treneri i tyre.

— Krosi është një garë e bukur sportive.

— Si t'ju them, unë nuk jam i dhënë shumë pas vrapimeve. Kurse ju, me sa duket, qenkeni i apasionuar!

— E gjetët.

— Ndryshe nuk do të detyroheshit të linit plazhin e bukur e detin e kaltër, për të ardhur këtu. Sa shpejt keni ardhur, brenda një ore!

— Kam ardhur me maqinën time.

— Më kot jeni shqetësuar. Ju mund të vinit dhe nesër. Vendin do t'jua kisha ruajtur.

— Ju falemnderit. Po atje, në plazh, edhe mër-zitësh. Sidomos këto ditë që frynte një erë e ftohtë dhe deti ishte i tërbuar.

— Nuk keni bërë keq. Këtu nuk do të mër-ziteni.

— Ashtu besoj unë. Epo, natën e mirë.

— Natën e mirë.

Mister Bllejbërgu u largua me hapa të shpejta. Portieri e shoqëroi me sy, gjersa u zhduk prapa dyerve të asensorit. Kishte shumë kohë që punonte në atë hotel, kish parë të hynin e të dilnin shumë turistë të huaj, po ky i qe dukur turisti më i çuditshëm me kureshtjen e madhe që kishte treguar për të ndjekur krosin ndërkombëtar, aq më tepër, kur në të nuk merrte pjesë ndonjë ekip përfaqësorjës i vendit të tij.

Portieri e shpjegonte këtë me pasionin e njerëzve për sportin. Ky pasion do ta kishte shtyrë

mister Bllejbërgun, i cili, me të dëgjuar në radio se do të zhvillohej krosi ndërkombëtar, kishte ardhur po atë natë në kryeqytet.

Portieri hodhi vështrimin jashtë hotelit. Dritat që depërtonin përmes xhamave, shkriheshin me dritën e butë të llampadarëve të kristaltë të hollit. Dritat hapeshin e mbylleshin e ashtu dukej se u ngjanin mijëra syve të ngulur në errësirën e natës.

Ora po i afrohej njëmbëdhjetës.

Kapitulli III

TREGIMI I LIZËS

Është dita e parë që ndodhemi në qytetin e huaj. Na kanë caktuar në një hotel modern. Nuk na pëlqen dhe aq, sepse ka shumë zhurmë. Po më e keqja është se këtu dhomat janë për një ose për dy veta, kurse unë nuk jam mësuar të fle vetëm fare. Albana dhe Besa nuk e kanë për gjë të flenë vetëm. Albana u tregua e gatshme të flinte në dhomën tjetër, që të mos mbetesha vetëm.

Të nesërmen u ngritëm më vonë se zakonisht. Kjo ndodhi ndoshta për shkak të lodhjes së djeshme. Nga ballkoni i hotelit soditëm pamjen e qytetit, që u zbulua para syve tanë dalngadalë pas një mjegulle të hirtë, që u shpërnda nën rrezet e diellit.

Sot vendosëm të njihemi me kuriozitetet e qytetit. Traineri na tha se një shetitje e tillë do të na zbaviste, madje dhe do të na lehtësonte për ditët e ngarkuara me stërvitje që na prisnin.

Zbritëm poshtë në holl. Qenë grumbulluar aty plot pjesëmarrës të ekipeve të tjera. Kur zbritëm, shumë prej tyre kthyen kokën nga ne. S'di sepse ndjeva një shqetësim. Nga të gjitha anët na drejto-

heshin vështrime të ngulta. Ata diç filluan të pëshpërisnin.

— Ç'thonë, vallë? — pyeta Albanën që kisha pranë.

— E pse bëhesh merak? — ma ktheu ajo duke vënë buzën në gaz.

— Po ti nuk e ndjen veten të shqetësuar? — i thashë unë.

— Jo, aspak. Kureshtja është e natyrshme në garat sportive.

— Po ti, a do të bëheshe kureshtare të dije diçka për ta?

— Edhe mund të bëhesha, ndonëse nuk do ta çfaqja kureshtjen time kaq hapur. Po, ti ke të drejtë për një gjë: vështrimi i tyre është ca këmbëngulës. Po eja, të mos vonohemi. Traineri dhe Besa po na presin te shkallët.

Ne kaluam përmes hollit dhe, kur po kapërcenim prakun e derës, gati sa s'u përplasëm me një burrë me syza të zeza. Kjo ndodhi krejt papritur. Burri me syza të zeza u zbraps, thua se kishte frikë mos ndoshta përpjekja do ta dërmonte. Ne u shikuam sy në sy, pa ditur ç'të thoshim. Burri me syza të zeza bëri përpara duke kthyer kokën dendur nga ne. Nuk mund t'ja shihnim sytë, se na pengonin syzat.

Brodhëm nëpër rrugët plot zhurmë të qytetit, pastaj shkuam deri në periferi me autobuz.

Sigurisht në qytetet e huaja ngjallin kureshtje. Njeriu njihet me gjëra të papara e të panjohura, për të cilat ka dëgjuar ose lexuar. Po mua po më tërhiqte më tepër peisazhi i qytetit. Ndoshta kjo ndodhi sepse, duke soditur kodrat, që ndiqnin njëra tjetrën si një karvan i gjelbër e pastaj ndaheshin

nga njëra tjetra si për t'i lënë vend të dukej maja e zbardhëlyer e një mali, m'u kujtuan kodrat që rrethojnë fshatin tim të lindjes, mali që ngrihet sipër tij e duket sikur e mban fshatin në pëllëmbë të dorës. Atë çast më pushtoi një mall për shtëpinë, për babanë, për të afërmit. Nuk e kuptoj dot përse ndodhi kjo. E pra, unë jam mësuar prej kaq vjetësh, që kurse kam shkuar në shkollë, të jem larg shtëpisë. Kjo mbase ndodhi sepse unë jam në një tokë të huaj e të panjohur, që shtrihet qindra e qindra kilometra larg atdheut. Edhe kështu mund të jetë. Po kujtimi sjell kujtimin!

Baba im i mirë!.. Sikur të kishe qenë dhe ti në aeroport. kur na përcollën!

Unë nuk e di çfarë mund t'i ketë ndodhur. Padashur ndjej një farë shqetësimi. Ai duhet të kishte ardhur. Kështu më pat premtuar, megjithëse e kish të vështirë të bënte tërë atë rrugë për të ardhur deri në kryeqytet. Ndoshta ka arritur vonë, kur aeroplani do të jetë shkëputur nga toka dhe do të jetë ngritur në qiellin e kaltër. Ndoshta i ka ardhur rëndë të vinte vetëm ai, një fshatar, atje midis njerëzish të panjohur.

Po sikur të ketë ndërruar mendje? Sikur të mos ketë dashur të vijë? Jo! Nuk është e mundur.

Megjithatë, unë prisja që ai të vinte. M'u duk vetja e vetmuar, ndonëse përkrah kisha Albanën, Besën, trainerin, sa e sa shokë e shoqe, që më përqafonin tërë zjarr në çastin e ndarjes dhe më urojnë udhë të mbarë e sukses.

Nga këto mendime më shkëputën Albana dhe Besa, që diç po i shpjegonin trainerit.

U kthyem në hotel. Po afrohej mesdita dhe koha po bëhej më e nxehtë.

Ngjitëm shkallët dhe u futëm në holl. Këtë radhë s'kishte pothua asnjëri. Vetëm në një cep më zunë sytë burrin me syza të zeza.

U bëmë gati të ngjiteshim sipër, kur, papritur, portieri i hotelit ju drejtua trainerit, duke mbajtur në duar një copë letër. Traineri falënderoi me kokë dhe na u drejtua neve.

— Telegram nga Shqipëria, — tha ai duke vënë buzën në gaz.

Merreni me mend se sa u gëzuam ne.

— Kush e dërgon? — pyeti Besa.

— Telegrami është për Lizën. Ja ka dërguar i ati, — tha traineri.

— Nga baba! — u habita unë.

Me duart që më dridheshin, rrëmbeva telegramin.

«Bijë e dashur! Arrita me vonesë, prandaj nuk munda të të përcjell. Të uroj ty dhe shoqeve të tua të ktheheni me fitore.

Baba yt»

Pra, baba kishte ardhur. Asgjë nuk kishte ndodhur. Ishte vonuar. Ua thashë këtë shoqeve dhe trainerit. Ata më mbuluan me vështrimet e tyre plot dashuri.

— S'kishte si të ndodhte ndryshe, Lizë! — më tha traineri.

U ngjitëm sipër. As vetë nuk kuptova si u ndodha në dhomë. Ndjehesha e kapitur. Ky telegram i papritur na kish ngazëllyer e ndodh jo rrallë që, nga ngazëllimi, njeriu të kapitet, siç do të kapitej po të ish tronditur nga një lajm i keq.

U ula në një kënd të shtratit tim, pa ditur ç'bëja.

— Lizë, unë dhe Albana do të freskohemi në banjë. Do të vish dhe ti? — më tha Besa dhe më preku lehtë me duart e saj të holla.

— Jo, unë do të vi më vonë, — ju përgjegja. Besa diç desh të shtojë, po Albana e mori për krahu.

— Mirë, Lizë, shlodhu pak, — tha ajo, sikur ta ndjente gjendjen time.

Të dyja më vështruan ëmbël dhe hynë në banjë.

Unë shfletoja telegramin, sikur të mos u besoja atyre që ishin shkruar.

Babai im i mirë! Sa shumë ngulte këmbë atëhere!..

Kjo është një histori që ndodhi një mbrëmje, nga fundi i marsit, kur isha kthyer në fshat për pushime. Ne kishim gjashtë ditë pushim, po unë do të qendroja vetëm dy ditë, sepse më duhej të shkoja përsëri në qytet, për të marrë pjesë në garat sportive midis shkollave.

Ngaqë doja të përfitoja kohë, u nisa që atë ditë për në fshat, me të mbaruar mësimi. Arrita në mbrëmje. Baba nuk e dinte që do të vija, ndryshe do të kish dalë të më priste.

Udhës më përshëndesnin fshatarë e fshatare që ktheheshin nga puna për hapjen e tokave të reja.

Disa nga shoqet që më panë nga dritaret e shtëpive, më dolën përpara. Rruga shkonte para kishës. Atje dy sy zunë e më ndiqnin me vëmendje. Në derë të kishës kishte qendruar Dom Kola me nja dy a tre fshatarë. Ai diç fliste me ta pa m'i ndarë sytë. Pastaj filloi të ngërdheshej, ndërsa fshatarët më vështronin me habi.

Sa e urreja atë njeri! Mirëpo, për fat të keq, shumë fshatarë e besonin dhe fjalën e tij e dë-

35790
49961

gjonin. Ata e mbanin Dom Kolën për shpëtimtar. Po kështu dhe baba im. Kur nëna që sëmurrur, baba, në vend që të kërkonte ndihmën e mjekut, pat rendur pas Dom Kolës dhe pat vepruar siç i kishte thënë ai.

Unë atëhere isha në shkollë, larg fshatit, dhe as që e dija që nëna ishte e sëmure shumë rëndë.

Vetëm kur ajo ishte në prak të vdekjes, më thirri baba. Atëhere Dom Kola po dilte nga shtëpia jonë, pasi kish bërë lutjen e fundit. Nëna vdiq në heshtje. Atë e kishte marrë në qafë Dom Kola.

Unë, duke qarë me dënese, ja thashë babës, megjithëse e dija se ai s'do t'i priste mirë fjalët e mia dhe do të zemërohej.

Po baba më hodhi vetëm një vështrim të butë e më tha:

— Mos, bijë, mos folë ashtu. Ti nuk mund t'i kuptosh këto gjëra. Shpirti i saj u ngjit sipër, te zoti, që i qofshim falë.

Kaq shumë e kish skllavëruar shpirtin e babës tim Dom Kola! Dhe jo vetëm të babës tim, po të tërë fshatarëve.

Po ai edhe tani po i mundonte ata e po përpiquej t'i mbante nën zgjedhën e tij. Po shpejt do të vinte një ditë e ai do të gjente atë që meritonte.

Baba u gëzua shumë kur më pa.

Dukej se gjithçka do të shkonte mirë. Po të nesërmen ndodhën të papriturat.

Ngjarjet rrodhën kësisoj.

Mbrëmjen e ditës tjetër, në vatrën e kulturës, të rinjtë bënë një mbledhje. Midis të tjerave ata ngritën edhe çështjen e Dom Kolës. Madje të gjithë folën kundër tij me mllef aq më tepër sepse ai u kishte marrë të holla fshatarëve kinse për të

ndrequr kishën, e ngulte këmbë se ato nuk mjaftonin. Mirëpo doli se ai i shpenzonte këto të holla për qejfin e tij.

Dom Kola do të demaskohej. Kështu vendosën të rinjtë.

Mbledhja vazhdoi ca, prandaj u ktheva vonë. U habita kur pashë babanë me fytyrë të vrarë e sy të çakëryer:

— Mallkuar qofsh, moj bijë!

Me këto fjalë më priti ai.

— Ç'thua kështu, o babë?

— Më ke mashtruar. Po më merr nderin, Lizë.

Unë mbeta e shtangur, pa ditur ç't'i thosha.

— Kush të prishi mendjen të merresh me sport?

— Vetë, o babë.

— Ç'marre! Më kapardise dhe në resme.

— Kush të ka folur kështu? — nuk m'u durua pa e pyetur.

— Dom Kola. Ishte pasdreke këtu. Bëri mirë që erdhi, megjithëse vonë.

Ai nisi të më tregojë se si Dom Kola kishte ardhur pasdite për vizitë në shtëpi, kur unë isha në mbledhje, e i kishte thënë se unë merresha me sport. Të kishte mbetur puna me kaq, s'do të kishte qenë asgjë e keqe. Ç'është e vërteta, unë vetë nuk i kisha kallxuar gjë babës, sepse kurrë nuk më kish shkuar ndërmend se, duke u marrë me sport, po bëja diçka të keqe. Po ja që Dom Kola e kishte thënë këtë, madje kishte shtuar se me sport gjoja u merrkan ato «të përdalat e qytetit», që nuk e kishin për turp të dilnin para njerëzve me kofshë jashtë. Dhe, për ta bindur babën, i kish treguar atij dhe një fotografi të një gazete, ku kisha dalë unë

dhe disa shoqe e shokë të shkollës sonë, që ishim sportistë të dalluar.

— Ah, more babë. Dhe ti i paske besuar këtij njeriu? — thashë unë tërë duf. — Ai është mashtrues.

— Mbyll gojën! Si guxon të përflasësh njerinë e zotit! — briti baba.

— Këtyre njerëzve tani ne po u tregojmë vendin.

Pas këtyre fjalëve ai më goditi me shuplakë. Këtë nuk e kishte bërë kurrë. Madje dhe rëndë nuk më pat folur kurrë. Po atij ja kish errësuar mendjen Dom Kola. E ndjeva veten të ganduara, po, megjithatë, nuk u tërhoqa.

— Nuk është ashtu si të ka thënë, babë. Po dije se ai është njeri i poshtër. Këtë nuk e them vetëm unë. Tërë fshati do ta thotë. Edhe ti do të bindesh. Ne do ta zhdukim nga fshati këtë pleh.

Baba dridhej nga zemërimi.

— O perëndi, — briti ai. — Kjo s'do të ndodhë kurrë! Gjëra të bukura paske mësuar në shkollë! Po tani morën fund të gjitha. Shkollë e sport bashkë.

— Ç'do të thuash, babë? Me gjithë mend e ke?

— Këtu do të të mbyll, moj nafakzezë!

— Jo, këtë nuk do ta bësh.

— Tani mjaft, nuk të za ma besë.

— Po unë pas dy ditësh duhet të jem në qytet. Kam gara sportive. Më kupton?..

Po ç'mund të kuptonte në ato çaste baba për garat sportive?

Ai më rrëmbeu me forcë për krahu dhe më shkapeti në dhomën pranë.

Pas derës ndjeva çelësin që rrotullohej në bravë dhe babën që turfullonte tërë inat.

— Aty ke për të ndenjë, kurrë nuk 'do të dalësh, derisa të të vinë mentë.

Kështu mbeta e mbyllur brenda katër mureve. Baba nuk donte të më linte të vazhdoja shkollën e sportin.

Lamtumirë mësimë, lamtumirë stadiume me korset e vrapimit!

Të pasnesërmen fillonin garat. Unë duhej të merrja pjesë në vrapimin e 800 metrave. Po sikur baba të vazhdonte të më mbante të mbyllur në këtë dhomë? Ç'turp do të ishte! Në shkollë, kur të merrnin vesh të vërtetën, do të thoshin se Liza e kishte babën fanatik.

Ja çfarë kishte pleksur Dom Kola.

Ai donte të më fuste në grindje me babën tim, donte të më ndante nga shoqet e shokët e shkollës, nga sporti, nga ëndërrat e bukura, donte të më varroste gjithçka të bukur. Ai donte të më ndante dhe nga Albana dhe Besa, shoqet e mia të mira, të dashura. Po e dëgjoj tani zërin e tyre. Ato e dinë tërë historinë time, ato e kuptuan përse u preka aq shumë kur mora telegramin e babës tim.

Historia ime u ka bërë përshtypje. Dhe s'kishte si të ndodhte ndryshe.

Tani ato do të vinë përsëri, do të më rrethojnë me ngrohtësi, për të më dhënë të kuptoj edhe njëherë se ajo që ngjau s'do të përsëritet kurrë më.

KAPITULLI IV

DUKE KUJTUAR NGJARJE TË SË KALUARËS

Mëngjezi ishte i kthjellët dhe plot dritë. Rrezet e diellit përplaseshin në perdet e gjera të dritareve të mëdha të hollit, që i thithnin si sfungjer, duke lënë të depërtonte një si dritë qumështore, që vinte nga vetë ngjyra e perdeve.

Traineri e gazetari i huaj kishin një copë herë që rrinin ulur në kolltukët e hollit. Ndoshta ngaqë kishin biseduar gjatë njëri me tjetrin e i kishin mbaruar temat e bisedave, ata dukeshin si të nemitur e kundronin njerëzit që hynin e dilnin në holl.

Papritur treneri ktheu kokën prapa.

— Ja, shikoni vajzat shqiptare, — tha ai duke ngritur flokët e kuqërremtë, që i kishin rënë mbi ballë dhe bëri me shenjë nga asensori.

— Cilat janë? — pyeti gazetari, duke hedhur një vështrim përreth.

— Ato nga e djathta e porterisë.

— Po ne nuk i pamë në aeroport.

— Arritëm më vonë.

— Më duken tepër të imta.

— Pse s'thua dhe shumë të drojtura.

— Jo, e ke gabim. Të duken ashtu nga mosha.

Po pse kanë qendruar aty? Duket presin dikë.

— Sigurisht. Presin trainerin e tyre.

Ata vazhduan të bisedojnë midis tyre.

Në holl u duk mister Bllejbërgu. Ai kishte veshur një kostum gri të hapët, që i rrinte pas trupit. Duke ecur me hapa të ngadalshme, u drejtua te kolltukët e fundit të hollit.

— Po ky ç'është? — pyeti treneri i huaj. — E kam parë shpesh gjatë këtyre dy ditëve të qëndrojnë afër sportistëve. Mos është ndonjë kolegu yt?

— Jo, është një turist anglez.

— Të ketë ardhur enkas për të parë garat?

— Nuk është çudi.

— Interesant, — tha me habi treneri i huaj.

Gazetari nuk ju përgjegj. Ai vazhdonte të thithte cigaren, duke lëshuar rrathë të hirtë, që ngriheshin e humbisnin sipër llampadarëve, të cilët varreshin në tavanin e lartë të hollit.

— Ja dhe treneri i tyre, — tha pastaj.

Traineri i huaj, që po shuante cigaren në tacketuken e kristaltë, ktheu kokën rrëmbimthi.

— Ky duhet të jetë, apo jo? — vazhdoi gazetari.

Po miku i tij nuk po i përgjigjej. Ai kish mbetur i trallisur nga habia, sytë i picërroheshin, vetullat i lëviznin me drithërimë, balli i rrudhosej, thua se diç po sillte ndërmend.

— Ç'pate kështu? — pyeti gazetari.

— E çuditshme, vërtet e çuditshme! Unë e njoh trainerin shqiptar.

— Bah, si është e mundur?!

— Madje e njoh mirë.

— Ti ngandonjëherë më shashtis. Si ka ndodhur kjo?

— Histori e vjetër. Para njëzet vjetësh, në

Shqipëri zhvillohej një takim garash ndërkombëtare të atletikës së lehtë. Ishte një takim i madh.

— Në mos gaboj, atëhere u organizua dhe një turne futbollit, ku merrte pjesë dhe skuadra jonë përfaqësuese.

— Pikërisht ashtu.

— Po ti ç'hyje në këtë mes?

— Ç'pyetje! Po s'ke faj, ne atëhere nuk njiheshim. Duhet ta dish se unë isha një atlet i shkëlqyer në garën e 110 metrave me pengesa.

— Më duket se më vonë u bërë i tillë.

— Gabon. Më vonë unë pësova katastrofë të plotë.

— Sa fatalist tregohesh kur flet kështu.

— Për fat të keq kështu është. E gjithë kjo ndodhi në Shqipëri.

— Po më bën të qesh.

— E kam me gjithë mend, — tha treneri duke u ngrysur në fytyrë.

Ai ndezi një cigare tjetër.

— Ato qenë gara të mëdha, ku merrnin pjesë atletë të disa shteteve. Madje mund të them se ishin ndër garat e para të mëdha që po zhvilloheshin ato vite. Shqipëria s'kishte mbushur ende dy vjet që ish çliruar, — vazhdoi treneri i huaj.

— Ç'do të thuash me këtë? — e pyeti gazetari.

— Që ajo po rimëkëmbej nga lufta, nga shkatërrimet.

— I vure re atëhere ato?

— Mua ato pak më interesonin. Shtete të mëdha mezi po rimëkëmbeshin e jo më Shqipëria. Megjithatë, garat qenë organizuar bukur; madje mjaft bukur. Siç të thashë, unë do të merrja pjesë në garën e 110 metrave me pengesa. Mendoja se

nuk do të kisha asnjë kundërshtar të rreziqshëm. Ndaj isha i qetë, i sigurtë se do të fitoja. Shorti më solli pranë shqiptarit: do të vrapoja në një korsi ngjitur me të. Ai dukej një tip i heshtur, nga ata që para garës duken të përqendruar, pa e çarë kokën ç'bëjnë atletët e tjerë pjesëmarrës rreth tij. Dhe ke parë ti se nuk ja bënte bef syri. Ti e kupton se, të vraposh 110 metra me pengesa, do të thotë ta përshkosh këtë largësi shumë shumë në gjashtëmbëdhjetë sekonda. Unë këtu kam parasysh rezultatet rekord të atyre viteve. Siç e di, çdo gjë në garat e shpejtësive varet nga shkëputja në sprint^o). Në sprint u shkëputa i pari. Po i kaloja fluturimthi pengesat. Spektatorët e ndiqnin garën të heshtur. Befas vura re se ata po duartrokisnin. Madje po brohorisnin me të madhe. Në fillim pandeha se mos këto më drejtoheshin mua. Po shpejt kuptova se nuk ishte ashtu. Atleti shqiptar, që kisha lënë prapa në sprint, po më arrinte. Nga pas unë ndjeja frymëmarrjen e tij. Pas pengesës së nëndë, ai ndodhej vetëm disa centimetra pas meje. Pengesën e dhjetë e kaluam në një kohë. Ai më kish arritur. Në finish^o) m'u duk se përsëri arritëm barabar. Po kisha gabuar. Pikërisht ai që s'e prisja, atleti shqiptar, ma kish kaluar. Kjo ishte katastrofë e vërtetët!

— Fillove përsëri të flasësh me gjuhën e fatalistit? — qeshi gazetari.

— Kam të drejtë të shprehem kështu. Me t'u kthyer në atdhe, unë nuk fitova më asnjë garë.

^o) Sprint quhet fillimi i një gare

Humbisja gjithnjë. Ç'është më e keqja, humba besimin në vetvete.

— Epo nga kjo ka ardhur dhe katastrofa për të cilën po flet.

— Jo, jo, katastrofa nisi atëhere kur humba garën në Shqipëri. Punët filluan të më venë keq e më keq, aq sa u detyrova të braktis pistën. Çudi si u rrukullisën kështu ngjarjet! E di se ky shqiptari nuk më është ndarë kurrë nga mendja?

— Je i sigurtë që treneri i këtyre vajzave është pikërisht atleti për të cilin po flet?

— Për besë, ti më habit me këtë pyetje.

— Po kanë kaluar njëzet vjet! Nuk i thonë shaka!

— Le të kalojë një jetë e tërë. Atë nuk e harroj kurrë. Vërtet i kanë rënë ca flokët, po shumë pak ka ndryshuar. Si mund t'i harroj ato çaste kur ai u buzëqeshte spektatorëve ndërsa ekzekutohej hymni kombëtar e flamuri shqiptar ngrihej lart!

Ata mbetën gojëkyçur një copë herë.

— A u ngrit dhe herë tjetër flamuri shqiptar në stadium? — pyeti pastaj gazetari.

— Po, — u përgjegj treneri duke u munduar të sillte ndërmend se kur ish ngritur.

— Flamuri u ngrit kur skuadra përfaqësuese shqiptare fitoi turneun e futbollit.

— Pikërisht ashtu! — u habit treneri i huaj.

— Po ti nga e di?

— Skuadra jonë përfaqësuese mund të zinte vendin e parë, po për këtë duhej që shqiptarët të humbisnin ndeshjen e fundit me një skuadër tjetër që sapo ishte mundur, — tha gazetari, pa ju përgjegjur pyetjes së tij.

— More, po nga i di ti të gjitha këto?

— Mirëpo skuadra shqiptare fitoi me një gol që u shënua aty nga fundi i lojës, pas një goditje dënimi, dhe kështu zuri vendin e parë.

— Oo, kjo i kalon të gjitha parashikimet e mia. Po më flet tamam si orakull. Ti, ose ke qenë vetë atëhere në Shqipëri, ose ke lexuar diku, madje tani shpejt, se ndryshe nuk do t'i mbaje mend këto hollësi.

— As që kam qenë e as që kam lexuar gjë, mik i dashur.

— Po nga i mësove këto atëhere?

— Edhe kjo ka historinë e vet. Tani më duket se erdhi radha ime të të tregoj diçka. Këtu e disa vjet të shkuara jam njohur me një gazetar anglez, me një farë mister King. Ti mbase ke harruar ose as nuk je interesuar të dish, po shqiptarët vitet e fundit fituan medaljet e argjenta në një turne të madh futbollit, ku morën pjesë disa skuadra të njohura.

— Vërtet, kam dëgjuar, po më duket se ka qenë diçka e rastit.

— Të lemë mënjatë mendimin tënd, — e ndërpreu gazetari, — sepse pikërisht ky mister Kingu më pat thënë se shqiptarët në futboll, atëhere kur nuk e pret, mund të bëjnë çudira. Dhe si shembull më solli turneun për të cilin ti fole pak më parë.

— Edhe ai pat qenë atëhere në Shqipëri?

— Madje për të dytën herë.

— Posaçërisht për të parë këto ndeshje futbollit?

— Jo. Atëhere, nëpërmjet UNRRA-s^o), në Shqi-

^o) Organizatë ndërkombëtare për të ndihmuar vendet e dëmtuara nga lufta e dytë botërore, që imperialistët anglo-amerikanë u përpoqën ta përdorin për qëllime diversioni në vendin tonë.

përi venin shumë gazetarë të huaj, që shkruanin për gjendjen që ishte krijuar pas çlirimit. Dhe ai ishte ngarkuar nga gazeta e tij të shkruante rreth këtyre ngjarjeve. Mirëpo rastisi të ndodhej ditën kur mbyllej turneu ndërkombëtar i futbollit. Ishte hera e dytë që vinte në Shqipëri pas dhjetë vjetësh. Atëhere pat shkruar disa reportazhe mjaft të goditura; pat shkruar për një malësor trim, që nuk e turpëroi familjen, po e lau gjakun, për një ballo të shkëlqyer në Pallatin mbretëror, ku kish patur rastin të bisedonte me vetë mbretin e atëhershëm të shqiptarëve, që i ishte dukur një burrë i mençur dhe i bukur; për një dasmë shqiptare në kullat e një bajraktari, e cila e kish lënë pa mend me këngët, vallet e rakinë që rridhte lumë. Dhe ja ku kishte vajtur tani të shkruante për gjëra të reja.

— Po ç'hyn këtu ndeshja e futbollit?

— Dale, mos u nxito. Mister Kingu vendosi ta niste reportazhin e tij pikërisht nga stadiumi, ku do të zhvillohej kjo ndeshje, me një nëntitull sensacional: «Një fiasko e shqiptarëve». Pastaj mbresat e tij për ndeshjen do t'i lidhte me ngjarjet e atyre muajve, pasi kryeministri dhe ministri i jashtëm grek ishte ngritur në konferencën e paqes në Paris dhe kishte shtruar problemin e Vorio-Epirit.

— Këto çështje nuk më kanë interesuar kurrë! — tha me indiferentizëm treneri i huaj duke mbledhur buzët. — Po dua të di ç'ndodhi më vonë me këtë gazetar.

— Ai u njoh me një korespondent francez, — vazhdoi gazetari, — që kishte vajtur në Shqipëri po për këtë qëllim. Mirëpo, ai burrë i pjekur, me pamje të zyrtë, nuk i kishte pëlqyer. Kur kishte

mësuar qëllimin e vajtjes së tij në Shqipëri, ai, duke kryqëzuar duart me trishtim, i kishte thënë se gjatë dhjetë ditëve të qendrimit të tij në Shqipëri, e kishte patur të vështirë të shkruante, sepse nuk kishte gjetur atë që kërkonte, atë që kish menduar dhe shpikur në kokë. Prandaj duhet t'i rikujtohte ose t'i përpunonte faktet e kundërta, me të cilat po hasej përditë.

— I shkreti, nuk paska patur fare fantazi!

— E vërteta është se dhe mister Kingu kish vënë re se nuk ishte gjithçka ashtu siç i kishin thënë. Shenjat e luftës qenë zhdukur e Shqipëria e dyzetegjashtës pak i ngjante asaj të dhjetë vjetëve më parë. Mos ke patur dhe ti këtë përshtypje? — ju drejtua gazetari trainerit që, siç duket, kish filluar të dëgjonte me vëmendje këtë tregim të zgjatur.

— Të thashë dhe më parë se mua pak më interesonte atëhere si ishte Shqipëria. Po s'do mend edhe ndonjë gjë kish ndryshuar. Nuk i thonë pak dhjetë vjet.

— Mister Kingu vajti në stadium. Nën shkallët e stadiumit kishte parulla të mëdha, në të cilat shkruheshin, në mos gaboj, parulla për mbrojtjen e atdheut, për ndërtimin e jetës së re. Kështu? Traineri pohoi me kokë.

— Pastaj ai drejtoi vëmendjen nga tribuna qendrore. Pritej të vinin udhëheqësit. Sytë e të gjithëve qenë ngulur andej. Mister Kingut, siç më tha, i shkoi mendja, siç na shkon jo rrallë herë ne gazetarëve, te diçka që mund të ngjiste në ato çaste: mendoi sikur turmat të ngriheshin e të sulleshin drejt tribunës qendrore. Pastaj një e shtënë, dy të shtëna, një atentat!!

— Unë nuk di të ketë ngjarë ndonjë atentat,
— tha treneri i huaj, që nuk e kishte patur mendjen te fjalët e fundit të gazetarit.

— Unë nuk thashë se ngjau ndonjë atentat, po kështu pat menduar mister Kingu. A ishe ato ditë në ndeshje?

— Po.

— Të kujtohet se ç'ndodhi kur erdhën udhëheqësit shqiptarë?

— Më duket se në stadium duartrokitën.

— Pikërisht ashtu. Duartrokitën shumë.

— Po çfarë duhet të bënin tjetër?

— Çështja është se ata shprehën kështu simpatinë dhe dashurinë për udhëheqësit e tyre, ndërsa mister Kingut i kishin thënë ndryshe në atdheun e tij.

— Më duket se ky korespondent anglez paska qenë një psikopat, a, më mirë të them, një hajvan i tërë.

Gazetari nuk e mbajti gazin pas këtyre fjalëve që treneri i huaj i tha tërë zemërim.

— Pastaj filloi ndeshja, — vazhdoi gazetari.

— Lere, mos ma kujto se edhe atë e mbaj mend.

— Edhe ajo të ka lënë përshtypje të keqe?

— Domosdo. Me atë fitore, shqiptarët na rrëmbyen vendin e parë. Një gol shënuan, po ç'është e vërteta të bukur. Qe një goditje e fortë dënimi.

— Përfytyroni entuziazmin e tyre.

— Ishte vërtet diçka tronditëse. Po ti nuk më the ç'ndodhi me korespondentin anglez.

— Edhe ai e ndjeu veten të tronditur. Thirrjet «Shqipëria, Shqipëria» i dukej se e goditnin drejt e në kokë. Dësh të dilte nga stadiumi, po nuk kish

se si. Vetëm kur u dëgjua hymni kombëtar, ai pat rast të çante turmat e njerëzve, e zbriti shkallët. Përballë tij, në anën tjetër të shkallëve, pa të zbriste korespondentin francez. Po ai bëri sikur nuk e pikasi dhe iku tepër i zhgënjyer, sepse kurrë nuk kish besuar se do të fitonte Shqipëria.

— Mister Kingu t'i ka thënë të gjitha këto?

— Mos pandeh se janë pjellë e fantazisë sime.

— Ç'sinqeritet prej idioti! Habitem si nuk ka patur turp që të qenka hapur kështu. Do të ketë pësuar ndonjë traumë psikike.

— Sa cinik që tregohe, — e qortoi gazetari i huaj.

— Po thuamë, a nuk kam të drejtë?

— E vërteta është se ai bëri një gabim tjetër.

— Çfarë?

— Pas nja dy ditësh iku nga Shqipëria, pa shkruar asgjë.

— Gomar i tëri paska qenë! Sikur nuk kishte gjë për të shkruar.

— Këtu ke të drejtë.

— Ti si do të kishe vepruar?

Gazetari mori një pamje serioze dhe u ngrys në fytyrë.

— Shiko këtu, — tha, — nuk jam zemërpulë, as sentimental.

— Nuk ja përplase në fytyrë atij kalemxhiu të dështuar?

— Po mos pandeh se ai ka bindje pozitive apo simpati për shqiptarët.

— Po atëhere, pse nuk shkroi?

— Ai desh të verë në dukje të kundërtën e asaj që ti the më parë: që sukcesi i shqiptarëve në

atë turne ndërkombëtar futbollit nuk ka qenë aspak i rastit.

— Më mirë e lemë këtë bisedë. Ç'është e vërteta, s'dua të vras kokën për gjëra të shkuara. Mua tani më intereson krosi që do të zhvillohet dhe vendi i parë.

— Të është përforcuar kjo bindje?

— Dhe më tepër, sidomos tani, pasi njoha ish kundërshtarin tim. Pas kaq vjetësh po takohemi në të tjera role, megjithëse përsëri të njëjtë. Po tani, he, he, është radha ime. E kaluara s'do të përsëritet.

— Më pëlqen optimizmi yt, — i tha gazetari duke i rrahur shpatullat. — Ngrihem tani. Vetëm ne paskemi mbetur në holl

— Sikur pashë atje në cep turistin anglez.

— Edhe unë e pashë. Siç duket qenka ngritur.

— Do të jetë dhe ai një psikopat, si korespondenti për të cilin fole.

Ata përshkuan hollin dhe zbritën poshtë shkallëve, duke biseduar me zë të lartë.

KAPITULLI V

NË FUSHË

Autobuzi u ndal anës një rruge të asfaltuar, që dredhonte përmes një fushe.

Vajzat dhe treneri zbritën nga autobuzi. Tutje rrugës shtrihej një fushë e gjerë, që vende-vende ngrihej, duke formuar kurrize të blerta.

Përpara ecte treneri. Albana diç po u tregonte Besës dhe Lizës, që e dëgjonin me vëmendje.

Thellë fushës drejtoheshin shumë njerëz të tjerë: përgjegjës e pjesëtarë ekipesh, organizatorë të krosit ndërkombëtar, kureshtarë.

Më së fundi ata u ndalën pranë një peme të madhe, që zgjatte krahët, si të donte të mbulonte fushën me hien e saj.

Prapa tyre, disa punëtorë po përfundonin së ndërtuari një tribunë portative. Po bëheshin përgatitjet e fundit për krosin ndërkombëtar.

Të gjithë kundronin me kureshtje përreth.

Ja, këtu do të zhvillohet krosi, — tha treneri, duke treguar me dorë përpara. — Si ju duket terreni?

— Nuk është i ngritur pak atje në kodër? —

pyeti Besa dhe sytë e saj morën një pamje të drojtur.

— Vërtet, është ca i ngritur. Dhe, me sa më thanë, itinerari i krosit do të kalojë andej nga fillimi i garës. Megjithatë, nuk ka asgjë për t'u shqetësuar.

— Edhe mua kështu më duket, — tha Albana. — Në kemi zhvilluar tërë ato stërvitje nëpër kodra, moj Besa. Pse, të duket i vështirë vendi?

Besa vuri buzën në gaz me drojtje.

— I vështirë mbase jo, po edhe i lehtë nuk më duket.

— Ke të drejtë, nuk e ke njohur ende. Tani do të fillojmë të stërvitemi dhe ke për të parë që pjesa e terrenit, që zgjatet në kodër, nuk është më e vështirë nga ngjitjet që kemi kryer në kodrat e kryeqytetit tonë, — tha treneri.

Vajzat u bënë gati të fillonin stërvitjen. Në fushë qenë shpërndarë vajzat e ekipeve të tjera.

Nga larg u dëgjua buria e një maqine. U duk një veturë e bardhë që rrëshqiti në mes të fushës dhe u ndal në një kënd të saj.

Nga maqina zbriti mister Bllejbërgu. Ai u bë gati të mbyllte derën e maqinës, kur papritur një nga punëtorët aty pranë diç i bëri shenjë me dorë e diç i sqaroi. Mister Bllejbërgu pohoi me kokë, pastaj u fut sërish në maqinë e u kthye mbrapsht. Siç duket, aty ishte e ndaluar të qëndronin maqinat.

Në këto e sipër, në fushë kishin ardhur mjaft njerëz. Ata kishin filluar të uleshin në shkallët e tribunës portative, që po përfundohej. Mister Bllejbërgu qëndroi një hop, pastaj ndezi një cigare dhe,

me hapa të ngadalshme, u drejtua edhe ai te shkallët e tribunës.

Traineri po interesohej të dinte hollësisht të tjera të itinerarit të garës, ndërsa tri vajzat po bëheshin gati të fillonin stërvitjen.

— E di ç'm'u kujtua tani, Liza, — tha Albana. — Takimi ynë i parë në stadium. E mban mend? Dhe atëhere ne po i zvizhnim tutat në fushë siç po i zveshim tani. Kisha dëgjuar se një atlete e re e një qyteti tjetër, që do të merrte pjesë në garë, kishte arritur rezultate të mira, po nuk e njihja.

— Kurse unë të njihja mirë, — tha Liza, — kisha dëgjuar për ty e, me ta thanë troç, e ndjeja veten të shqetësuar.

— Si 'moj kështu?

— Veç ta kishe ditur ti, moj Albana! Më dukej se po më merrej fryma. Po buzëqeshja jote më ngrohu.

— Vërtet?

— Ta merr mendja. M'u duk se më the: «Mos u druaj, he burrneshë? Këtu të gjitha jemi shoqe».

— Edhe mua më kanë folur për këtë garë, — tha Besa.

— Pse, nuk more pjesë ti atë ditë? — pyeti Albana.

— Jo, madje as nuk e pashë, sepse isha sëmurë.

— Ishte një garë e fortë, apo jo Liza?

— Çka të them: u mundova të ndjek grafikun tënd.

— Pas çdo hapi ndjeja që të kisha pranë. Ti nuk m'u ndave. Madje dhe më kalove.

— Më thuaj të drejtën, moj motër: po a nuk të mori disi frika? — i tha si për ta ngacmuar Liza.

— Ç'është e vërteta, ajo shkëputja e furishme më habiti, po për t'u frikësuar nuk u friksova. Për një gjë isha e bindur.

— Për çfarë?

— Po të vazhdonte gara me atë ritëm, rekordi do të thyhej.

— A do të të kishte ardhur keq po të humbisje vendin e parë?

— Kur një shoqe e jotja meriton fitoren e, për më tepër, thyen dhe rekordin kombëtar, nuk ka pse të të vijë keq. Ndryshe do të ishte egoizëm. Çështja është që kjo të bëhet nxitje, për të arritur rezultate më të mira në të ardhmen. Po ty të erdhi keq që unë të kalova në kthesën e fundit?

— Unë e prisja të ndodhte ashtu. Më kishin thënë që ti e ke sprintin e fundit tepër të shpejtë, megjithatë vrapova sa munda.

— Dhe vrapove mirë.

— Merre me mend shendin e gazin tim, kur mora vesh se dhe unë, megjithëse e dyta, kisha thyer rekord kombëtar.

— Më kujtohet: ti atëhere kërceje dhe përplasje duart.

— Pse e pakët të duket ty?

— Ke të drejtë, Lizë.

Vajzat, pasi lanë tutat dhe çantat sportive në një tendë anës fushës, u drejtuan nga treneri që vinte përballë tyre.

Në atë çast, në fushë po hynin gazetari i huaj dhe treneri, që kishte përkrah vajzën me flokë të verdhë. Pas tyre vinin dy vajzat e tjera.

Mister Bllejbërgu, duke tymosur, ndiqte me vëmendje nga tribuna ç'po ndodhte në fushë.

KAPITULLI VI

KUSH ËSHTË MISTER BILLEJBERGU?

Asnjë nuk mund të kuptonte në ato çaste se sytë e tij, përmes syzave të errta, nuk lëviznin në për fushën e blertë, ku kishin filluar të strëviteshin ekipet, që do të merrnin pjesë në kros, po qenë për-qendruar vetëm atje ku qenë vajzat shqiptare. Madje ato çaste ai do të donte të ndodhej pranë tyre, pa rënë në sy të askujt, e të dëgjonte se për çfarë flisnin.

Për një gjë ishte i sigurtë; ato nuk flisnin për të. Dhe nuk kish përse të flisnin, sepse nuk e njihnin.

Po ai e njihte njërën prej tyre, ose, më mirë të themi, e kish njohur vite më parë. Tiparet e saja i kishte ndryshuar koha, aq sa ai e kish shumë të vështirë ta njihte. Megjithatë një gjë kishte rëndësi: me siguri ishte një nga ato tri vajza. Ndoshta ajo fytyrërrumbullakja aq e shkathët dhe e gjallë, që s'e zinte vendi kudo që të ish, në holl, në restorant, në koridoret e ndritshme të hotelit luksoz, ose aty, në fushë, pa u drojtur fare, thua se ndodhej midis njerëzve të njohur; ndoshta ajo flokëzeza, me baluke të rëna mbi ballë, si ato vajzat e hijshme malësore. Po mund të ishte dhe ajo tjetra disi e heshtur, me fytyrë pakëz të hequr, që dukej se diç ndrydhte në zemër.

Kush mund të ishte? Tiparet e tyre pak i ngjanin asaj vajze të brishtë që kish njohur atëhere. Ai mbante mend se ajo kishte qenë shumë e gjallë, e shpejtë; në kujtesë i ishte ngulitur vështrimi i saj i fundit, që shprehte çudi, turbullim, shqetësim, po jo frikë. Madje ai vështrim shprehte urrejtje, vetëm urrejtje. Ai këtë e pat ndjerë, ndaj dhe qe dridhur.

Ajo, pra, ndodhej aty, ishte një nga ato të trija. Nëse mendja e tij, sado e fortë, nuk mund të mblidhte fijet e shkëputura të kujtesës, të tretta në shtjellën e harresës, emri i vajzës ishte udhërrëfyesi që do ta nxirrte nga ky pështjellim.

Atë emër, që harresa s'do ta shlyente kurrë nga mendja e tij, e kish lexuar në një nga gazetatat shqiptare, që i binin në dorë, kur kishte mësuar lajmin se një ekip vajzash shqiptare do të merrte pjesë në një kros ndërkombëtar, që do të zhvillohej jashtë Shqipërisë.

Lajme të tilla ai dhe shumë shqiptarë të arratisur si ai kishin mësuar jo rrallë. Delegacione shqiptare, qofshin kulture, sportive apo edhe të tjera, kishin shkuar dhe në vendet e perëndimit. Disa prej këtyre shqiptarëve «të rremë» u ishte ngarkuar që të binin në kontakt me pjesëtarë të delegacioneve. Qëllimi ishte i qartë: të bindej ndonjë prej tyre të mos kthehej në atdhe.

Po asnjëherë nuk ja kishin arritur qëllimit. Bllejbergu i rremë shkonte me mendimin se kishte ndodhur ashtu sepse agjentët nuk kishin ditur të vepronin, sado që përpiqeshin të çfajsoheshin se pjesëtarët e delegacioneve shqiptare nuk ndaheshin kurrë nga njëri tjetri, kudo që shkonin. Ata ngul-

nin këmbë se ishte e vështirë edhe të ballafaqohesh e jo më të bije në kontakt me ta.

Sipas tij, kurrsesi nuk mund të ishte kjo arsyeja: diçka tjetër duhet t'i kish penguar të vepronin. Dhe kjo vinte nga ndjenja e ethshme që i kapte ata në çastet kur ndodheshin para njerëzve, të cilët kishin ardhur nga vendi prej nga qenë arratisur, duke shpëtuar me njëmijë mundime lëkurën e tyre, prej vendit ku ata e kishin ndjerë veten të tepërt, të humbur midis asaj vale të furishme revolucionare që do t'i kishte mbytur.

Dhe ja, pas kaq vjetësh atyre që kishin marrë arratinë si ai, u ziente gjaku dhe si përgatiteshin në shkollat e spiunazhit, hidheshin përsëri në atë vend, të bindur se diç do të bënin për të qetësuar hakmarrjen e tyre gjakatare. Mirëpo, pa zbritur mirë, zhdukeshin pa lënë gjurmë. Të tjerë, duke mësuar fatin e tyre, tregoheshin më të përmbajtur, nuk arrinin deri atje sa të shkonin për dhjamë qeni, po ëndërronin ta shuanin urrejtjen me ndonjë mënyrë tjetër, si duke u takuar me pjesëtarë të delegacioneve shqiptare, për të tërhequr me vete ndonjë prej tyre, me qëllim që ta diskreditonin.

Mirëpo ajo ndjenjë e ethshme që i kapte në fillim, në vend që t'u jepte zemër të vepronin, i mpinte, ua paralizonte të folurit shqip, i tralliste e kështu ata tërhiqeshin e misioni u dështonte. Prania e shqiptarëve të ardhur i trembte. Ja, kjo ishte e vërteta.

E kishte ai tani radhën të vihej në një rol të tillë. Madje e kishte pranuar me shumë dëshirë detyrën që i kishin caktuar, sepse njërën nga këto tri vajza e kish njohur vite më parë dhe në rrethana të jashtzakonshme, kur po arratisesh, kur ishte

në rrezik jeta e tij, e ardhmja e tij. Dhe kjo vajzë, me veprimin e saj, mund të kishte shkatërruar gjithçka. Atëhere ai nuk pat mundur ta zhdukte. Tani, pas' kaq vjetësh, po i jepej një mundësi e tillë. Askush nuk mund ta pengonte. Në këtë ambient plot zhurmë dhe të huaj mund ta kryente atë akt me lehtësinë më të madhe, pa lënë gjurmë. Po ky do të ishte thjesht një krim. Ai do të shuante kështu një urrejtje të përbindshme, ose, më thjesht, një hakmarrje vetjake. Mirëpo kjo binte në kundërshtim me detyrën e tij si agent informator. Ja, kjo ishte pengesa: ai nuk duhej ta zhdukte atë, po të përpiqej me çdo kusht ta tërhiqte me vete. Po ta zhdukte, do të pësonte një dështim edhe më të madh nga ç'kishin pësuar sho-kët e zanatit të tij.

Këtu luftonte ndjenja e hakmarrjes gjakësore e një tradhëtari me detyrën. Kjo ishte një dilemë jo e thjeshtë për t'u zgjidhur. Po duhet të fitonte detyra, sepse për këtë paguhej.

Kështu, me këtë lëkundje të madhe shpirtërore, që i shembëllente një deti të trazuar, ai kishte ardhur në atë qytet të huaj, ku po zhvillohej krosi ndërkombëtar, me një detyrë të përcaktuar mirë. Dhe këtë detyrë do ta kryente me çdo kusht. Ai s'do të druhej, si ata të tjerët, të ballafaqohej me atë vajzë, sado pengesa t'i dilnin përpara.

I fshehur nën emrin e mister Bllejbërgut, ai nisi nga puna që natën kur kishte biseduar lirshëm dhe shpenguar me portierin e hotelit. E vërteta është se kishte arritur vonë; të nesërmen i kishte pritur në holl, po ato nuk qenë dukur. Pastaj kishte zbritur shkallët e ish drejtuar në lulishte, me shpresë se do t'i shihte aty. Po edhe atje nuk i kishte parë.

Mbi ballin e gjerë të hotelit, midis flamurëve të ekipeve pjesëmarrëse në kros, dalloi dhe flamurin shqiptar, me yllin e kuq, që ngrihej mbi shkabën dykrenore. Pas aq vjetësh po e shihte përsëri atë flamur. Kishte ndër një drithmë ta përshkonte si korent elektrik. Ndoshta kjo i kishte ardhur sepse, kur e kish parë, i kish shembëllyer si një shpend i zjarrtë, gati t'i hidhej përsipër.

Dhe ja, duke ngjitur shkallët, ai papritur u ndodh përballë dy vajzave, që diç po bisedonin me zë të lartë. Ato po flisnin shqip, bënin shaka dhe qeshnin.

Ai kishte parë se si ato qenë bashkuar me një burrë, që ecte duke patur përkrah një vajzë tjetër. Mund që ai ishte treneri i tyre.

Ishte e qartë që ato nuk e kishin njohur. Dhe s'kish si ta njihnin. Në atë vend të huaj, ai për të gjithë ishte i panjohur. Ai ishte një turist anglez, i quajtur mister Bllejbërg, e asgjë më shumë.

Kështu ai kish parë vajza shqiptare për herë të parë pas aq vjetësh. Ato fytyra nuk ju dukën as të vrëjtura e as të trishta. Po cila nga ato të trija ishte, pra, vajza që pat njohur kur banonte në qytetin e vogël? Familja e tij kish pasur një fermë dhe një punishte frutash. Po, pasi fuqinë e morën ata që çliruan Shqipërinë, i humbi të gjitha: fermën, punishten, të ardhurat. Dhe kjo sepse babai kish qenë i pasur, sepse u kish shërbyer regjimeve të pushtuesve. Prandaj atë e kishin arrestuar dhe dënuar me shumë vjet burg.

Ai nuk bëhej merak për të jatin. Mirë t'i bëhej. Le të kalbej atje. Për faj të tij kishin ndodhur të gjitha këto. Po të ishte treguar më i zgjuar, ata do të kishin ikur me kohë e do të ishin vendosur

në ndonjë vend të huaj, larg, shumë larg Shqipërisë. Po i ati nuk kishte dashur. Ai kish gjukuar se komunistët do t'i kishin ditët e numëruara e përsëri do të vinin kohët e arta. Sipas tij, kjo duhet të ngjante shpejt. Mirëpo kjo nuk ndodhi. Kështu i kishin humbur të gjitha.

Për të jetuar, ai qe detyruar të punonte. Dhe jo vetëm ai, po të tërë pjesëtarët e familjes.

Kështu kishin ardhur ditët e zeza dhe të rënda, që kurrë nuk do të mbaronin. Atëhere kishte njohur dhe një vajzë të vogël, që banonte pranë shtëpisë së tij. Qe e imtë dhe shtatvogël. E kish parë tek luante te sheshi përpara lagjes. Kish filluar të merrej dhe me sport. Madje ai i kish folur njëherë rëndë kur e kish parë. E vërteta është se e kish lëshuar ca gjuhën dhe kjo kish ndodhur se ish ca i dehur. Atij nuk i kujtohej mirë se ç'i kish thënë, po duhet të kish qenë diçka fyese, sepse vajza e vogël, Albana, kështu e mbante mend të quhej, ja kish dhënë vrapit.

Kështu kishin kaluar për të ditët, kështu do të kalonin dhe vitet. Kështu do të ngrysej dhe jeta e tij. Po kjo s'mund të ndodhte. Ai duhej të bënte diçka. Në Shqipëri nuk mund të jetonte.

Dhe ai kishte vendosur të arratisëj. Atëhere qe mpleksur me një grup. Po i kishin ndodhur shumë të papritura. Të gjitha brenda një nate. Atë natë për pak do të kish humbur përgjithmonë dhe shkaktare kishte qenë Albana, vajza sportiste, të cilën ende nuk po e njihte.

Duke ndenjtur në shkallët e tribunës, ai vazhonte të ndiqte lëvizjet e vajzave shqiptare.

Ai me siguri do të mësonte, madje së shpejti, se cila ishte ajo vajzë.

KAPITULLI VII

VAZHDIMI I NJË BISEDE

Ata të dy kishin qendruar, si dy ditë më parë, në të njëjtat poltrona të hollit të hotelit. Gazetari i zhytur në leximin e një libri, ndërsa treneri i huaj vështronte nga shkallët e hollit ata që hynin e delnin. Ishte koha që në hotel kishte më shumë lëvizje.

— Ama dhe ti, — tha treneri i huaj pas një heshtjeje të gjatë. — Mbetë duke lexuar.

Gazetari vuri buzën në gaz.

— Po ç'të bëj? — tha. — Duhet gjetur një mënyrë për të kaluar kohën. Kështu më ndodh gjithnjë kur nuk kam punë.

— Ç'lexon ashtu. Ndonjë roman?

— Jo. Ti e di që letërsia nuk para më pëlqen. S'para më pëlqejnë krijimet e fantazisë së njerëzve.

— Kurse mua s'më pëlqen fare të lexoj. Për mua leximi është një torturë e vërtetë.

— Gabim. Njeriu duhet të lexojë; kryesorja është të lexojë ato që lidhen me ngjarjet, faktet e botës.

— Edhe ato nuk më lipsen. Ata që duan le të merren me botën. Unë kam botën time, kjo më intereson. Megjithatë, nuk më the ç'libër po lexon.

— Është një libër mbi historinë e diplomacisë së këtij shekulli. Ka gjëra tërheqëse. Do ta lexosh?

— Bah! Diplomacia është për diplomatët. Lere mënjanë atë libër dhe eja të bisedojmë.

— Mik i dashur, të them të drejtën, unë e kam vështirë të bisedoj me ty.

— Mos do të thuash se jam i mërzitshëm?

— Jo, nuk e kam fjalën aty. Të më kuptosh drejt. Po ti nuk i jep shteg bisedës.

— Do të thuash se kundërshtoj?

— Po, je ca këmbëngulës.

— Më duket se nuk është keq të ngulësh këmbë. Megjithatë, sa herë që do të bisedoj me ty, do ta kem parasysh që mos të të kundërshtoj.

Gazetari qeshi pas këtyre fjalëve.

— Nuk më thua, — tha, — a e ke ndërmend të njihesh, apo, më mirë, të rinjihesh me trainerin shqiptar?

— Edhe më pyet? Më fal, po kjo është fare e tepërt.

— Dale, mos u rrëmbe.

— Si të mos rrëmbehem! — u nxeh traineri i huaj, duke ngritur supet. — Ose unë nuk kam ditur të flas, ose ti nuk më ke dëgjuar fare dy ditë më parë.

— Unë të kam dëgjuar me shumë vëmendje. Për këtë të jesh i bindur. Po të isha në vendin tënd, do të njihesha, po jo të miqësohesha; përkundrazi, gjatë njohjes do t'i qendroja ftohtë, krenar, që t'i lija të kuptonte se ajo që ndodhi atëherë, që gjë e rastit dhe se pas kaq vjetësh ajo nuk do të ndodhte më kurrë.

— Ke të drejtë. Megjithatë, edhe kjo gjë nuk më pëlqen.

— Më fal, po mos druhash përsëri nga ndonjë e papritur?

— Për mua nuk ka më të papritura. Unë jam njeri praktik. Ekipi im do të fitojë. Pra, njohjen ndoshta do ta bëj në fund. Atëhere ne, dy ish kundërshtarët, do të ndodhemi përballë. Le që nuk është aspak çudi që ai të më ketë njohur. Më duket se nuk kam ndryshuar shumë gjatë këtyre njëzet vjetëve.

— Kjo varet nga kujtesa e tij.

Gazetari la mënjanë librin dhe ndezi një cigare.

— Me sa shoh, argumenti shqiptar e bën bisedën tonë të rrjedhshme dhe interesante, — tha gazetari.

— Në qoftë se nuk ma thua me shpoti, — u përgjegj treneri i huaj, — do të të përgjigjesha se po.

— Më duket se po keqkuptohemi.

— Nuk besoj. Më duket se ky argument të pëlqen dhe ty.

— Plotësisht e vërtetë, megjithëse unë nuk nxitem nga ato arsye të forta që të shtyjnë ty.

— Ke qenë ndonjëherë në Shqipëri? — pyeti treneri i huaj.

— Jo, për fat të keq. Megjithëse për Shqipërinë di shumë gjëra.

— Mund të dish shumë dhe mund të dish pak. Kjo është relative. Unë për veten time habitem me këto vajza. Si kanë ardhur deri këtu?

— Ç'do të thuash?

— Fanatizmi në Shqipëri i ka rrënjët e thella. Këtë e kam parë atëhere me sytë e mi. Nëpër rrugë shikonim gra e vajza, po ç'është e vërteta shumë prej tyre mbanin perçe të zeza. Shihnim

dhe gra që punonin në kantiere ndërtimi, po ky ishte një fenomen i rrallë.

— Po në garat e atletikës a patën marrë pjesë vajza?

Traineri i huaj picërroi sytë dhe u mendua ca.

— Më duket se po, — tha pastaj duke zvaritur fjalët. — Qenë aq pak, sa numëroheshin me gisht.

— Po mos harro se që nga ajo kohë ka rrjedhur shumë ujë nën urë.

— E pastaj?

— Shumë gjëra dhe kanë ndryshuar. E di ti se në Shqipëri flitet se po bëjnë përpjekje të mëdha për të ndryshuar jetën e vajzës dhe gruas?

— Ç'thua, more! Në një vend ku vajzat dhe djemtë i fejojnë që në djep!

— Edhe këto fejesa dhe martesat po i prishin.

— Nga i ke marrë vesh ti?

— Kam lexuar materiale të ndryshme. Ti duhet ta kuptosh: është profesioni që më lidh me faktet dhe ngjarjet e botës.

— Gjepura. Pandeh se këto punë bëhen me fushata. Duan shekuj të zgjidhen këto. Nuk është çudi që këto vajza t'i kenë detyruar të vinë këtu. Lere ti se ç'thonë shqiptarët. Apo nuk më beson mua?

— Mund të jetë dhe ashtu.

— Ja, kjo mënyrë të foluri nuk më pëlqen. Nga disa arësytetime ngandonjëherë më dukesh si filoshqiptar.

— Ç'budalla që bëhesh! Si të shkon ndërmend një gjë e tillë? Unë filoshqiptar?! — tha gazetari duke bërë një lëvizje nervoze.

— E pse jo! Pak njerëz ka në botë që, duke lexuar diçka për Afrikën ekuatoriale, mund të tho-

në «Ç'ekzotikë, ç'mrekulli! Atje është parajsa e vërtetë!» Dhe harrojnë të gjorët se atje, në pyjet e malet fantastike të Afrikës, ka dhe leopardë e gjarpinj. Kështu, mik i dashur, mos u beso librave, qofshin ato aventuroze, letrare apo dhe diploma-tike. Besoju syve.

— Më pëlqeu ky deduksion. Megjithatë, çdo gjë duhet parë me gjakftohtësi, pa u nxituar. E pa-rë e punës, unë nuk lexoj materiale të shkruara nga shqiptarë. Unë lexoj materiale të atyre që shkruajnë për Shqipërinë dhe i krahasoj me ma-terialet shqiptare. Atëhere nxjerr përfundimin tim. Kështu bëj për çdo vend.

— Edhe ata që shkruajnë për Shqipërinë janë filoshqiptarë. Pra, janë subjektivë.

— S'është e vërtetë! Ka dhe nga ata që janë armiq të tërbuar të Shqipërisë. Të parët lëvdojnë, të dytët shajnë. Të dy palët janë, pra, subjektivë.

— Domethënë asnjë nuk paraqet të vërtetën?

— Të vërtetën duhet ta nxjerrësh duke bërë krahasime.

— Më duket se po më jep një mësim logjik. Gazetari tundi kokën në shenjë mohimi.

— E po si thua ti? Që Shqipëria po ecën ma-dhërisht përpara, siç thonë vetë shqiptarët? — tha treneri i huaj.

Gazetari e shikoi ngultas dhe sytë papritur i shkëlqyen.

— Ti e di që këto vitet e fundit është folur shumë për Shqipërinë. Këtë mbase është e tepërt të ta them. Një shtet i vogël, i rrethuar ngado, e megjithatë po jeton, — i tha.

— Varet se si, — e ndërpreu treneri i huaj.

— Ashtu është, këtë nuk e dimë. Po fakti është

fakt. E kjo të habit, të tërbon fare. Mendo se atëhere, kur ndodhën ngjarjet që ti i di, gjykova se Shqipëria jetonte ditët e fundit. Dhe jo vetëm unë, po tërë shtypi ndërkombëtar këtë mendim ka shprehur. Ç'mund të bënin vetëm një milion e ca shqiptarë?

— Të mbështeteshin te ndonjë mik i fortë, i madh.

— Ashtu vërtet. Edhe këtë mik e kanë, ndonëse shumë të largët gjeografikisht. Po ata kanë edhe një parim të tyre: besimin në vetvete. Këtë e kanë garanci kryesore.

— Ç'mund të bëjë vetëm një shtet i vogël si Shqipëria, aq më tepër në këto kushte?

— Është për t'u habitur. Mua, siç të thashë, më ka interesuar vazhdimisht çështja shqiptare.

— Dhe në ç'përfundim ke arritur?

— Ngandonjëherë më vjen inat të nxjerr përfundime. Po ata në vend s'kanë mbetur. Madje kanë ecur përpara.

— Do të bëje mirë të shkoje vetë në Shqipëri.

— Patjetër do ta bëj këtë, po duhet gjetur rasti.

— Se mos e pëson si ai gazetari anglez, — e ngacmoi treneri i huaj.

— Duhet të pësoj një disfatë sportive, ashtu siç e pësove dhe ti — u përgjegj aty për aty gazetari. — Sepse në vendin e tyre duket qenkan të rrezikshëm.

Traineri i huaj bëri sikur nuk kuptoi gjë.

— Po sikur të ishte zhvilluar ky kros në Shqipëri, — tha pastaj gazetari, — he, a do të ishe ndodhur përpara të papriturash?

— Bah, ç'thua? Njëherë ndodhi ajo.

— Ja, ti gjithnjë rrëmbehe. E di që gjatë këtyre vjetëve të fundit shqiptarët kanë korrur disa fitore të rëndësishme në futboll? Besoj se duhet të të kujohet: dy skuadra shtetesh të mëdha nuk fituan dot në Shqipëri. Kjo ka bërë bujë në tërë Evropën.

— Ah, më fal. Kur është fjala për futboll, po. Shqiptarët mund të bëjnë të papritura, aq më tepër kur luajnë në fushën e tyre. Unë kam gjithmonë parasysh atë ndeshjen që kam parë vetë. Po jashtë shtetit dhe ata e kanë tepër të vështirë të luajnë. Për futbollistin shqiptar, publiku plot temperament dhe stadiumi i tyre janë si toka për Anteun.

— Më pëlqen ky krahasim, — tha gazetari, të cilit i pëlqente edhe vetë të fliste me figura. — Po, megjithatë, nuk duhet harruar se dhe jashtë shqiptarët nuk kanë luajtur keq. Ndryshe nuk ka si shpjegohet fakti që, veç atij turneut, për të cilin të fola pardje, ata kanë fituar medalje të argjenta dhe në një turne tjetër ndërkombëtar. E duhet shtuar se dhe atje merrnin pjesë skuadra të njohura.

— Më habit kujtesa jote. Duket se po specializohesh për problemet shqiptare.

— Jo, nuk është çështja te kujtesa ime. Duke qenë i dhënë mbas sportit, këto fakte më kanë bërë përshtypje dhe s'më kanë dalë nga mendja.

— Të tilla suksese shqiptarët nuk mund të arrijnë më. Të thashë njëherë, kur nuk janë në tokën e tyre...

— Po edhe këtu publiku, për fat të keq ka simpati për shqiptarët. Dhe për më tepër jo vetëm në sport.

— Nga e nxjerr këtë përfundim?

— Nga përvoja ime si gazetar.

— Po ti nuk i ke parë asnjëherë skuadrat shqiptare! — u nxeh treneri.

— Kam parë delegacionet shqiptare që kanë marrë pjesë në konferenca, apo kongrese ndërkom-bëtare. Të vjen të pëlçasësh kur sheh që, me t'u ngritur përfaqësonjësit shqiptarë, të tërë në sallë sikur ngrijnë e mbajnë vesh.

— Vetëm në Organizatën e Kombeve të Bashkuara ka ndodhur kjo.

— E ke gabim. Kjo ka ndodhur dhe gjetkë. Më kujtohet Kongresi i partizanëve të Paqes që u mbajt para nja tre vjetësh në Helsinki. Folën shumë përfaqësonjës. Salla dukej e përgjumur. U ngrit përfaqësonjësi shqiptar. Salla u gjallërua. Shqiptarët, kur flasin, nuk kanë zakon të përsëritin të tjerët.

— Kanë tezat e tyre.

— Të kundërta me të tjerët, — theksoi gazetari. — Dhe, megjithatë, fjala e tyre dëgjohej shumë më tepër se fjala e përfaqësonjësve të shteteve të mëdha. «Kjo është e vërtetë» thoshin në sallë. Të presësh të vërtetën nga përfaqësonjësi i një shteti të vogël! Po, që të mos ta zgjas, në kohën që po fliste shqiptari, u ngrit një mjekrosh. Të them të drejtën, dukej si gjysmë i pirë. Ai ju drejtua shqiptarit. Diç tha nëpër dhëmbë dhe e kërcënoi me grusht. Ç'është e vërteta, ky ishte një skandal diplomatik. S'i thonë shaka të shtrëngosh tjetrin me dhunë të mos flasë. Sigurisht mua m'u bë zemra mal. Mirëpo shqiptari nuk e prishi qetësinë. Përkundrazi, e ngriti dhe më shumë zërin. Në sallë u dëgjuan murmuritje.

— Që shqiptari të ulej?

— Përkundrazi. Që të ulej ai mjekroshi. Kurse pas fjalës së shqiptarit, pati duartrokitje. Po kësaj ç'i thua?

— Mund të ndodhë dhe kështu, mik i dashur, po në këtë kros delegacionin sportiv shqiptar nuk kanë për ta duartrokitur. Përkundrazi. ne do të na duartrokasim.

— Harrova të të them. Në fillim të bisedës më fole për fitoren. Mua si gazetar, nuk më pëlqejnë lëvdatat dhe deklaratat e nxituara. Kaq bin-dje ke se do të fitosh?

— As mos dysho. Për këtë kemi kohë të bisedojmë.

Dhe treneri i rrahu lehtas shpatullat gazetarit që po e kundronte me vëmendje.

KAPITULLI VIII

HISTORIA E FOTOGRAFISË

(Tregon Albana)

Sot u stërvitëm më tepër se ditët e tjera. Edhe dy ditë dhe do të fillojë kr'osi ndërkombëtar, ndaj duhet të përgatitemi mirë. Pasi hangrëm darkë, vendosëm të qendrojmë në parkun e vogël para hotelit. Edhe netët kanë filluar të jenë të nxehta dhe, në hotel, ajri, megjithëse ventilohet, është ca i rëndë, kurse në park fryn një puih e lehtë.

Liza e ndjente veten pak të lodhur, ndaj na kërkoi leje të ngjitej në dhomë. S'ka asgjë për t'u shqetësuar. Gjatë këtyre netëve ka bërë një gjumë të çrregullt. Ndoshta kjo ka ndodhur ngaqë nuk është ambientuar ende me klimën e vendit, siç ndodhi me Besën. Ç't'ju them për Lizën. Unë dhe Besa e kemi bërë shoqe për kokë. Është tepër e çiltër e çdo gjë e thotë me zemër të hapur.

Nuk qendruam gjatë në park. Pas gjysmë ore, si u ndamë nga treneri, unë dhe Besa u kthyem në dhomë.

Lizën e kish zënë gjumi. Ajo, siç duket, kish dashur të lexonte më parë diçka, sepse drita e abazhurit qe e ndezur.

Kur ju afruam pamë se, mbi komodinë, pranë abazhurit, ishte një fotografi.

Unë dhe Besa u shikuam sy në sy dhe vumë buzën në gaz. Ajo është fotografia më e dashur e Lizës: në të shihet vetë Liza në stadium pas një gare sportive, e pranë saj i ati. Po, po i ati, që nuk donte ta linte të merrej me sport. Ai vështron drejt aparatit fotografik me sy të habitur, sikur të jetë zgjuar nga një ëndërr e keqe, kurse Liza duket e drojtur, madje dhe e tronditur.

Ai që do ta shikonte për herë të parë atë fotografi, me siguri do të çuditej e nuk do të kuptonte asgjë. Kurse unë e di mirë historinë e asaj fotografie. Për të një gazetar pat shkruar një përshkrim shumë interesant, që ndonjë shkrimtari mund t'i vlejë për të shkruar një tregim, ndoshta dhe një novelë apo roman. Historinë e fotografisë ma ka treguar dhe ritreguar disa herë vetë Liza.

Lexuesit ndoshta i kujtohet nata kur i ati i Lizës, Paloka, e mbylli vajzën në dhomë që të mos e linte të shkonte në qytet. Këtë e kish bërë i nxitur nga ato që i kishte thënë prifti i fshatit, Dom Kola.

Atë natë, mbas nja dy orësh, Paloka kishte hyrë në dhomë t'i jepte së bijës për të ngrënë. Me të hapur derën, ai kishte hedhur sytë brenda, po në errësirën që kish pllakosur dhomën, s'dallohej asgjë. Mos flinte Liza?

— Heu! — briti, pasi rrotulloi sytë nëpër dhomë. — Lizë moj, ku je, Lizë!..

Asnjë përgjigje.

Nga të kish ikur vallë? Nga dritarja?

Zgjati kokën jashtë saj. Po të qe hedhur që andej, do të qe bërë copë në kalldrëm. Diku duhet

të ish kapur. Pas hardhisë. Po si e kish arritur?
Hardhia ish larg.

Vuri re se bastuni i babait të tij, që e mbanin të varur në mur, ish pranë dritares. Ja me kë e kish afruar hardhinë. Pastaj ishte kacavjerë e kishte zbritur teposhtë.

Ai u llahtaris, duke e përfytyruar të bijën varur pas hardhisë. Edhe një burrë i fortë zor se do të mund ta bënte këtë, e jo pastaj ajo.

Po ja që Liza e kish bërë. Sigurisht, këto marifete i kish mësuar atje, në shkollë, duke u marrë me atë sport të mallkuar.

Po ai duhet ta arrinte e të mos e linte të shkonte!

I ati i Lizës u bë gati të nisej, po pastaj mbeti. Kushedi se ku kish ikur ajo?.. Ndoshta tani mund të ishte në qytet. Ishte natë.

Do të shkonte të nesërmen, do ta kapte të bijën që po bënte mëkatë pas mëkate e do ta mbyste me duart e tij.

Të nesërmen në mëngjez, i ati i Lizës ish në udhë për të kërkuar të bijën, që kishte marrë arratinë.

Në fillim kish menduar se mos Liza ishte fshehur në shtëpinë e ndonjë shoqeje. Po, kur i kish parë vajzat te porta e shtëpisë, që pyesnin për shëndetin e saj, kish kuptuar se ajo s'mund të ish në fshat, po atje, në qytet.

Udha ish e largët. I duhej të ecte katër orë më këmbë. Po ai vinte me shpresë se mos gjente ndonjë maqinë.

Bëri një copë udhë, kur në kthesë dëgjoi zukatjen e një kamioni që po afrohej. Priti dhe bëri shenjë me dorë.

Shoferi frenoi.

— Për në qytet? — pyeti i ati i Lizës.

— Hipë, — i tha shoferi duke i bërë shenjë me dorë.

Me një kërcim, Paloka u gjend në karroceri. Atje i zuri syri një fshatar të ri që mbante në duar një fëmijë jo më shumë se tre vjeç, i cili dukej se flinte. Pranë tij ishin dhe tre fshatarë të tjerë.

Fshatari me fëmijën në duar ishte tepër i shqetësuar. Herëpashere fshinte me një shami fytyrën e skuqur të fëmijës që mezi merrte frymë.

Maqina rrëshqiste anës rrugës.

Një copë herë, fshatarët qëndruan të heshtur, secili i zhytur në mendimet e vetë. Herë-herë vështroheshin në sy, po nuk shkëmbenin ndonjë fjalë.

Pas pak fëmija nisi të qante.

— Pusho, mor bir i babës, — i foli fshatari, — edhe për pak do të arrijmë.

— Ku po e çon? — e pyeti më në fund një nga fshatarët.

— Në qytet, te mjeku.

— Pse, është sëmurë?

— Rëndë fort, madje.

— Po ç'ka?

Fshatari me fëmijë mblodhi supet, ndërsa sytë e tij shprehnin lodhje, përdëllim. Pastaj tha:

— Ku ta di unë. Kam një javë që nuk kam genë në shtëpi. Mbrëmë erdha. Ndhimësmjekja e fshatit tonë, kur e pa, më porositi ta çoj në qytet, se fëmija është në rrezik.

Babai i Lizës mbante vesh.

— Pse, a s'mund ta shërosh në fshat?

— Po përderisa thotë ndihmësmjekja ta çoj në qytet!

— Ama dhe ju të rinjtë me gjithë këta mjekë!
Ta kishe çuar te prifti. Dinte ai si ta shëronte.
Tërë fëmijët kështu i kemi shëruar, — foli fshatari.

— Mos ma zer me gojë priftin, — e ndërpreu tjetri. — Ata të shtëpisë, kur s'isha unë, në kishë e çuan për ta kunguar. Po ai prifti i mallkuar për pak ma mori më qafë...

I ati i Lizës ngrysi vetullat. Po për të folur nuk foli.

— Fëmija e komshiut tim vdiq, megjithëse e kish kunguar prifti, — nisi përsëri fshatari me fëmijë.

— Ashtu ka qenë shkruar.

— Dikur kështu besoja dhe unë. Po fëmija i një brigadieri, që kishte në fytyrë e trup po këto shenja të kuqe që ka im bir, nuk vdiq.

— Po të tërë nuk do të shkojnë në qiell!..

— Jo, mund të shkonte në qiell, po ai i bëri një gjilpërë në qendrën shëndetësore.

— Ajo gjilpëra ta ketë shpëtuar? — ndërhyri një fshatar tjetër.

— S'di ç'të them. Po ai fëmijë është sot shëndoshë si molla, kurse fëmija ime është bërë keq e disa fëmijë të tjerë kanë vdekur. Ajo ndihmësmjekja na tha se në fshat ka rënë një sëmundje shumë e rrezikshme për fëmijët.

— Pse nuk ja bëre atëhere gjilpërën fëmijës?

— «Është tepër vonë», më tha ndihmësmjekja. Ah, prifti i mallkuar! Sa burra e gra ka marrë më qafë!

— Pse?

— Sepse, kur sëmureshin, duke besuar shumë, vetëm te ai shkonin, megjithëse prej kohe jemi bërë me ndihmësmjek.

I ati i Lizës mezi po e përmbante veten. Ky fshatar, që s'duhet t'i kish kapërcyer të njëzet e pesë vjetët po villte vrer. Pse, mos ndoshta për vdekjen e gruas së tij kish faj prifti i fshatit. Ajo kish qenë tepër e sëmurë. Prifti që lutur shumë për të. Ç'mund të bënte tjetër? Këto ishin gjëra që nuk vareshin nga ai. Prandaj, kur i kishte vdekur e shoqja, ai nuk kishte ndjerë ndonjë pezmatim. I tillë kish qenë vullneti i zotit.

Kurse ky fshatar fliste me një gjuhë tjetër. Ashtu si i fsiste Liza. Të gjithë të rinjtë kishin filluar të flisnin kështu.

— Po tani u mbush kupa, — foli fshatari. — Sot të gjithë, burra, gra e fëmijë, kanë për t'u mbledhur për t'ja treguar vendin priftit të mallkuar.

Babai i Lizës u step. Kudo po ndodhte si me priftin e fshatit të tij.

Më së fundi arritën. I ati i Lizës u përshëndosh me fshatarin e ri, e uroi, ndonëse ftohtë, që fëmija të shërohej, u përshëndosh dhe me fshatarët e tjerë, falënderoi shoferin dhe u zhyt në lumin e njerëzve. E kish humbur, po zhurma e qytetit e përmendi. Po ai nuk duhet të humbiste kohë, ndaj çau turmën e njerëzve dhe u dha këmbëve drejt e në shkollë të Lizës. Kur po ngjiste shkallët, ndeshi me tre të rinj.

— Ku janë nxënësit? — pyeti si për të nisur bisedën.

— Në stadium, — u përgjegj njeri prej tyre.

— Në stadium? — u çudit i ati i Lizës.

— Po, po, në stadium.

— E ç'bëhet atje në stadium?

Të rinjtë qeshën e nisën të flasin:

— Po interesohet axha. Çudi!

— Ndoshta i pëlqen!

— Atje bëhen disa gara. Si të të them, a ke qenë ndonjëherë në stadium?

— Jo, kurrë, — ju përgjegj i ati i Lizës.

Atëhere djali me fytyrë të imtë nisi të shpjegojë:

— E pra, atje djem e vajza vrapojnë, kërcejnë kush e kush t'ja kalojnë njëri tjetrit, a më kupton?

— Disi, — u përgjegj i ati i Lizës i turbulluar.

— The se ka dhe vajza?

— Po, janë vajzat e shkollët sonë. Ne po shkojmë, axhë.

Ata u bënë gati të niseshin, kur, papritur, djali shtatshkurtër e i shëndoshë, që kish mbetur i heshtur duke vështruar me vëmendje të jatin e Lizës, foli:

— Ndaluni, djema! Më duket se ky është i ati i Lizës.

— Jo, more! — kundërshtoi njëri, duke u bërë gati të ikë. — Liza na tha se të jatin e la të sëmurë. Prandaj erdhi vonë në shkollë.

— Ky është i ati i Lizës. E njoh mirë. E mba mend kur e solli në fillim të shtatorit në shkollë. Por po e pyesim. Axhë, mos je ti i ati i Lizës?

Atij ju pre zëri. Këta, pra, ishin shokët e Lizës. Dhe për në stadium po shkonin.

— Po... unë jam, — belbëzoi.

— A nuk ju thashë? Me siguri ke ardhur të shohësh Lizën në garë. Gjë fort e rrallë kjo, s'më kishte shkuar kurrë në mend.

Babai i Lizës nuk dinte ç'përgjigje t'i jepte. Ai nuk do të kishte dashur kurrë t'i takonte këta djem, kurse papritur po ndodhej midis tyre.

— A dini çfarë? — nisi pastaj, pa ditur ç't'u thoshte.

— Hiç mos folë, e morëm vesh. Na falëndero që na gjete.

— Po pse nuk na the qysh në fillim, mor axhë?

— I ka ardhur rëndë me sa duket.

— E pse? Të shohë bijën e vet?

— Të mos humbim kohë, nxito dhe ti, axhë. Do të kënaqesh kur ta shohësh Lizën. Sa sportiste e mirë që është!

Dhe kështu, ata tre të rinj, duke diskutuar njëri me tjetrin, e rrëmbyen me vete.

Më në fund arritën në stadium.

Një mori njerëzish mbushnin shkallët e stadiumit. Dhe të tërë këta për të parë Lizën me shoqet e saj kishin ardhur. E ato do të dalin ashtu... «Bëje zot ëndërr!» — tha me vete i ati i Lizës i llahtaritur.

Kaluan përmes radhëve të njerëzve që shtrëngoheshin.

— Ulemi këtu! — foli djali i gjatë. — Prej këndej gara ndiqet mirë. Paskemi ardhur tamam në kohë. Gara s'ka filluar.

— Tani do të fillojë? — pyeti i ati i Lizës.

— Me siguri tani. Kaq nuk po të durohet? — ndërhyri një djalë tjetër me fytyrë të zeshkët, duke vënë buzën në gaz. — Thuaj si të duash, po qenka sportdashës axha.

— E si të mos jetë. Nuk i thonë shaka: do të vrapojë e bija.

Të kish arritur më parë, të mos kish takuar dhe këta djem që po e mbytnin me shpjegime, mbase do ta kishte hasur Lizën. Atëhere s'do ta kish lënë të dilte në fushë.

— Patjetër duhet të marrë pjesë ajo? — pyeti rishtas me një shqetësim të papërmbajtur.

— Patjetër! — u përgjegj, pa mundur të shpjegojë shqetësimin e tij djali i shëndoshë.

— Dua të them... që... askush nuk mund ta pengojë.

Të rinjtë ja dhanë gazit.

— E çuditshme. Për çfarë të shkon ndërmend, o axhë?

Kjo pyetje e turbulloi edhe më keq Palokën.

— Jo, unë ashtu kot pyeta. S'mund ta pengojë njeri?

— Sa i emocionuar duket! — foli djali me fytyrë të zeshkët. — E kush mund ta pengojë. Veç ndonjë i çmendur apo ndonjë prind fanatik. Po nuk do të guxonte. Mos u bëj merak. Liza do të marrë pjesë si një e një që bëjnë dy.

Së prapi po ja merrnin pyetjet këta të rinj. Pandehnin se ai interesohej për garën e flamosur.

I ati i Lizës e kuptoi se s'mund të bënte asnjë hap që të pengonte Lizën.

Po si ta linte të merrte pjesë në garë! Ndjente që po i merreshin mëntë e po e linin fuqitë.

— Si je, axhë? Dukesh pakëz i zbetë? — e pyetën të rinjtë.

— Ashtu... Mirë, — tha pa qejf Paloka.

— Je për t'u pasur zili, — nisi ai më i gjati, që po e mërziiste Palokën me mënyrën se si i fliste. — Të jesh i sëmure e të ngrihesh e të vish për të parë bijën në garë! Sa ka për t'u gëzuar Liza kur të të shohë!..

Këto fjalë ja ngritën nervat.

— Po shkoj t'i them, — u hodh i shëndoshi.

— Jo, jo, s'është nevoja! — u lut ai.

— Si të duash, axhë. Ah, tani po e kuptoj! Ke dëshirë ta përgëzosh Lizën pas garës? Bukur

e ke menduar! E papritur e këndshme, aq më tepër që Liza do dalë e para.

Babai i Lizës ziente përbrenda që po e keqkuptonin.

— E ku e di ti, more djalë, që ka për të dalë e para? — s'ju durua pa pyetur.

— Për atë mos u shqetëso. Është e fortë Liza! E para ka për të dalë. S'ka për të të turpëruar.

Liza e kish turpëruar me vaft e me kohë! Si u ngatërruan punët! Kurse këta po i jepnin zemër!

Papritur shpërthyen duartrokitje. Nga altoparlanti aty pranë kumboi një zë i fortë: «Vini re, vini re. Tani fillon gara e 800 metrave për femra!»

— Ja ku dolën! — foli njëri nga të rinjtë.

Dhe me të vërtetë, në fushë dolën një grup vajzash. I ati i Lizës mbylli për një çast sytë. Midis tyre do të ish patjetër dhe ajo e mallkuara... Hajde duro tani talljet e botës. Liza do të ish veshur për faqe të zezë. Tamam ashtu si kish thënë prifti i fshatit. Po bota gaz do!

Duartrokitjet që vazhdonin, e përmendën.

— Po këta përse rrahin shuplaka? — pyeti.

— I përshtëndesin, — shpjegoi i shëndoshi.

— Cilët përshtëndesin?

— Ato, mor axhë, vajzat!

— Ashtu, i përshtëndesin! Po pastaj ç'do bëjnë?

— Dukesh, o axhë, se vjen për herë të parë në stadium. Do të fillojnë të bërtasin pastaj.

— Të bërtasin? Ndoshta dhe të qeshin e të tallen! — tha i ati i Lizës.

— Kush të paska folur kështu, mor axhë?

— Jo, mor, askush! Po kot si më shkoi ndër-mend, — u përmbajt ai.

— Do të bërtasin që t'u japin zemër vajzave,

— shpjegoi djali i gjatë. — Natyrisht, jo të gjithave, po atyre që pëlqejnë.

— Që pëlqejnë!!

Babait të Lizës ju bë sikur dikush e goditi me forcë në kokë.

— Sigurisht, atyre që pëlqejnë. Përshembull, disave mund t'u pëlqejë të dalë e para ajo vajza e shkurtër, të tjerëve ajo e gjata...

Po ai as që guxonte të kthente kokën e të shih-te andej nga vajzat që bëheshin gati. Si mund ta shihte të bijën të veshur në atë mënyrë!

— Po juve kush ju pëlqen të dalë e para? — pyeti pas pak.

— E kush tjetër veç Lizës. E duam fort.

— Si, e doni fort?! — u shastis ai, duke përmbajtur me vështirsi veten.

— Po, po, të tërë. Jo vetëm ne të tre, po e tërë shkolla.

— E tërë shkolla!

Mor, po a ishte në vete ky thatuq, si ciragë, që nxirrte nga goja këto fjalë?

— Po, e tërë shkolla, — ndërhyri këtë radhë djali i shëndoshë. — Është vajzë e mirë ajo, s'e ka kush.

I ati i Lizës dëgjonte e s'donte t'u besonte veshëve.

— Për çfarë s'e ke, — vazhdoi ai. — Për mësi-me e para, për sport e para, për shoqëri po e para. Sidomos për shoqëri. Përshembull, mua më ka ndihmuar shumë në mësim. Ne shpesh rrimë bashkë.

— Rrini shumë?

— Me orë. Bashkë dhe stërvitemi.

Atij i erdhi t'i hiqte një shuplakë atij faqeziu.

— Që thua ti, axhë, edhe ky është sportist, si Liza, — shpjegoi i shëndoshi fluturimthi.

Paloka u mat të ngrihej e të ikte. E ndjeu veten të tepërt aty.

— Ku po shkon, axhë? Çfarë emocioni! — u hodh i shëndoshi. — Po ti shihi njëherë ato vajzat. A kishe për ta njohur midis tyre Lizën?

Atij i erdhi të hapej dheu dhe ta mbulonte bashkë me Lizën. Picërroi sytë, duke hedhur për-reth një vështrim të turbullt.

— Hë, mor axhë, e para nga e majta, me atë fanellën e kuqe. Po mos vuan nga sytë?

— Po, — murmuriti si pa dashur Paloka, pa gjykuar se gënjente.

— Sa keq! Po mos u mërzit, kur të afrohet afër nesh, do të ta tregoj unë Lizën.

Kurrë të mos ta shih-te atë!

Në shkallët e stadiumit shpërthyen britma.

Po, po. Tani u pa puna. Njerëzit do të fillonin të bënin sehir. E ai t'i duronte këta njerëz, të shih-te këtë pamje.

— Të dalësh e para, Lizë!

— Të na nderosh shkollën, qytetin!

Kështu thërrisnin njerëzit nga shkallët. Ç'do të thoshte kjo? Ata s'po tallehin. Pastaj aty s'ishin vetëm të rinj; aty kishte edhe burra, edhe gra.

— E shikon? Të gjithë për Lizën thërrasin.

— Liza të nderojë qytetin?! — u habit babai i Lizës.

— Është vajzë e rrallë ajo. Lum ti për bijë që ke!

Mendimet ju ngatërruan. Hajde, gjeje fillin tani... Po ndodhte krejt ndryshe nga ç'i kish thënë prifti i fshatit.

Ai e kishte gënjyer. I kish thënë se njerëzit tallen me ato vajza të përdala (si i kish thënë ato

fjalë!). Kurse ata, në shkallët e stadiumit, pa duartrokisnin, po brohorisnin.

Ju kujtuan fjalët e fshatarit të ri në maqinë. Ai kishte mallkuar priftin, sepse merrte më qafë njerëzit. Edhe atë fëmijë do ta kishte marrë më qafë po të mos e çonte te mjeku.

U dëgjua krisma e pistoletës e babai i Lizës u përmend. Vajzat zunë të vraponin.

— Më shpejt, vajza!

— Lizë, jepi shpejt!

— Përpara, Lizë!

Kur dëgjonte këto fjalë, atij i dukej sikur kraharori i zgjerohej e merrte frymë më thellë. Ç'po ndodhte kështu?

Liza vraponte e para. Po e arritën. Madje njëra dhe e kaloi...

Si kështu? Vështroi shokët e Lizës. Ata kishin mbetur të stepur. S'kishte për të dalë e para. Edhe shkollën dhe qytetin s'kishte për ta nderuar. «Po ti të paktën sot, moj marroqe, që del për herë të fundit», thoshte me vete.

Megjithatë më mirë kështu. Ta dinin të gjithë se Liza s'ish për atë punë e kështu do ta kishte të lehtë të mos e linte të merrte pjesë.

— Mos e humb, o axhë! Kanë edhe një rrotullim.

— Tani filloi ta marrë veten!

— Qenka e fortë, — s'arriti të përmbahej ai, duke dëgjuar inkurajimet e të rinjve.

— Do të të ketë ngjarë ty, mor axhë. Edhe ti i fortë je.

— Megjithëse sot duket i zbetë.

— E ka nga sëmundja.

— Jo, more, nga emocioni!

Ah sikur ta dinin ata sëmundjen e tij.

— Edhe pak, Lizë!

— Jepi më shumë...

Po të dilte e para? Domethënë se ishte më e forta. Epo mirë. Ta mbante mend për tërë jetën këtë vrapim. Pastaj fund të gjithave.

Çudi! Gjithë ky popull në stadium. Të gjithë për të parë vajzat, Lizën. Dhe jo për t'u tallur me to...

Po pse e kish gënjyer njeriu i kishës, njeriu i zotit?

— Shikoni Lizën!

— I arriti, more. Po e kalon të parën.

— Shpejto, Lizë!

Tani Liza vraponte e para, gjithnjë e para.

Po mos ta arrinin.

Ai, si pa e kuptuar, që ngritur më këmbë.

— Axhë, a e sheh, Liza po del e para! — folën të rinjtë.

— Me të vërtetë?

— Po, more axhë, ke për ta parë kur të ngjitet në vendin e nderit.

Bija e tij në vendin e nderit, para gjithë atyre njerëzve, që ishin në stadium!

— Qeshu, axhë! Do të gëzohet shumë Liza. Ajo nuk e di që ti je këtu. Eja ta përshëndesësh!

Të rinjtë po e merrnin për krahu.

— Unë? u shtang Paloka.

— Ti!

— Jo, më vjen marre!

— Pse të të vijë marre? Shiko gjithë këta njerëz përreth si buzëqeshin. E morën vesh se ti je babai i Lizës.

— Me mua buzëqeshin?

— Po, axhë, po eja të shkojmë!..

Djemtë e morën për krahu. I ati i Lizës ngurronte dhe e shihte me sy të hutuar. Si qe nisur e si po bitisej.

Atij i vinte t'ua hapte zemrën atyre djemve, që i kish patur aq inat në fillim, po fjalët i mbe-teshin në grykë. Po djemtë po e çonin drejt fu-shës, drejt Lizës.

Në stadium shpërthyen duartrokitjet. I ati i Lizës u drodh tek shihte të bijën kundruall tij.

Liza mbi podium lëshoi pa dashur një pshe-rëtimë. I ati ndodhej vetëm disa metra larg saj.

Kish ardhur ta përgëzonte për fitoren?!..

I ati dukej i zbetë. Vështronte të bijën me sy fajtori. Liza nuk arrinte të kuptonte asgjë.

— Babë! Ti babë... këtu?!

— Po, bijë!

— Më fal, po unë nuk mund të veproja ndryshe. Pastaj do të bisedojmë. Duhet të më kuptosh, do të bindesh pse ika ashtu...

— Ti paske pasë të drejtë!

— Babë!..

Babë e bijë u përqaftuan.

Një fotokorespondent nxitoi t'u afrohej.

— Ju lutem, qëndroni ashtu të përqaftuar! — u tha pastaj. — Dua t'ju fotografoj. Vetëm një se-kondë. Ja ashtu. Mbaroi dhe kjo punë.

Ja, kjo ishte historia e fotografisë.

Tani Liza po fle e qetë, dhe ndoshta sheh në ëndërr babanë e saj, për të cilin e ka marrë malli shumë. Ajo është e qetë dhe e lumtur. Unë këtë e di mirë. Telegrami i babait qe një gëzim i vër-tetë për të. Kish një kuptim të madh ai telegram.

«Fli, e dashur Lizë, fli. Natën e mirë».

MISTER BILLEJBERGU NUK KA GABUAR

Në sallën e restorantit kishte pak njerëz. Trajneri dhe vajzat shqiptare qenë ulur në një tryezë pranë dritares.

Mister Billejbergu mbeti disa çaste në mëdyshje, pa ditur si të bënte: të futej apo të mos futej. Nuk ishte çudi që, gjatë atyre ditëve, ai mund t'u kish rënë në sy vajzave shqiptare. Ndoshta atyre mund t'u kishte bërë përshtypje sjellja e turistit anglez. Ndaj, po të hynte, po të qëndronte shumë pranë tyre, mund t'u tërhiqte vëmendjen. Po dhe që të mos hynte atë çast, ai s'do të gjente vend të ulej pranë e kështu s'do të mund të dëgjonte asnjë fjalë nga biseda e tyre.

Ç'është e vërteta, atij nuk i interesonin bisedat e tyre, sepse, në fund të fundit, ato, sipas mendimit të tij, duhet të ishin të rëndomta: për kohën, për stërvitjet, për garën, për Shqipërinë. Ah, po, ato mund të flisnin për Shqipërinë. Edhe mund t'i kish marrë malli. Vajza të reja ishin. Po ai nuk ishte sentimental. Përndryshe, do ta kujtonte ndonjëherë me mall Shqipërinë. Mirë do të ishte po të shkëpuste ndonjë fjalë për gjendjen në Shqipëri, ndonjë

mendim të vetë vajzave. Të dëgjonte, përshembull, ndonjë ankim, pakënaqësi, sepse nga shprehja e fytyrave të tyre, asgjë të tillë nuk kishte dalluar. Kjo do të kishte qenë një garanci për të.

Megjithatë, tani për tani atij i interesonte një gjë: të dinte cila ishte ajo vajzë, që e kish njohur vjete të shkuara. Ish e çuditshme, po ato dy ditë ai nuk kishte arritur të mësonte gjë. E pra, ishte kaq e thjeshtë, po dhe kaq e vështirë. Për ta mësuar, do të mjaftonte dhe një bisedë tjetër me portierin e hotelit. Po druhej se mos portieri do të dyshonte. Ç'i hynte në punë një turisti anglez të dinte hollësira për vajzat shqiptare, aq më tepër që ato nuk kishin tërhequr vëmendjen e opinionit sportiv?

Ai po qendronte gjithnjë në koridor, i zhytur në këto mendime, kur, papritur, pa të futeshin në restorant disa njerëz. Bashkë me ta u fut dhe ai.

Traineri dhe vajzat shqiptare vazhdonin të bisedonin. Me ta ishin edhe dy pjestarët e tjerë të delegacionit shqiptar. Siç duket ndonjë përgjegjës, gazetar ose mjek. Ai zuri vend në një tryezë disa metra larg tyre. Ato as që e vunë re, sepse diç shfletonin në duar.

Nga altoparlanti i radios përhapej një melodi e bukur harqesh. Befas ndërhynte një trombë, që lëshonte një ulërimë të zgjatur.

Kjo lloj muzike zakonisht i pëlqente. Po atë çast e mërziste, sepse, ndonëse mbante veshët ngrehur, muzika e pengonte të dëgjonte fjalët.

Pastaj dalngadalë melodia filloi të shuhej. Vendi e saj e zuri një melodi më e qetë, që vinte si oshëtimë e largët. Ai porositi që t'i sillnin pastičio, biftek me patate të skuqura dhe shampanjë.

Të njëjtat gjellë kishin porositur dhe treneri e vajzat shqiptare, me të vetmin ndryshim se nuk po pinin shampanjë.

Befas i zuri veshi fjalën telegram. Ishte e qartë. Ndonjërës do t'i kishte ardhur ndonjë telegram. Po këtu nuk ishte fjala për një telegram. Në tryezë kishite disa telegrame.

Ai u mundua të sillte ndërmend se çfarë lajme kishin sjellë me vete ato telegrame, po nuk qe nevoja, sepse njëra nga vajzat tha pothuaj me zë të lartë:

— Të gjitha na urojnë të kemi sukses në garë.

Për pak ai nënqeshi, po e përmbajti veten. Ja, pra, ç'përmbanin ato telegrame. Për ç'suksese mund të flitej për ekipin shqiptar? Mos vallë vajzat mendonin se do të kishin sukses?

Ai kishte ndjekur me kujdes stërvitjen e asaj pasdite. E vërteta është se njëra nga vajzat i kish pëlqyer shumë. Ajo nuk ishte e gjatë, si një atlete e një ekipi tjetër me flokë të verdhë, që gjithashtu i kish bërë përshtypje, po kishte një hap elegant, një vrapim të lehtë e të vrullshëm. Sigurisht, nuk mund të fliste me kompetencë në këtë fushë, po sidoqoftë dukej që ajo do të kishte një të ardhme të mirë, po të binte në dorën e një treneri të zot, ta zemë të huaj, e po t'i krijoheshin kushtet. Po në Shqipëri do ta kishte të vështirë të bëhej e tillë, sado e talentuar të ishte.

Po as nuk pati kohë të mendonte gjatë, sepse befas dëgjoi zërin e trenerit që, duke ju drejtuar vajzës me fytyrë të rrumbullaktë, shqiptoi: «...Albana». Ai uli kupën e shampanjës që mbante në dorë, dhe për një çast u step.

Ëhë!... Ajo ishte Albana, Albana...

Rrokjet e këtij emri ju dukën sikur u trazuan me melodinë e rrëmbyeshme. Tromba dhe saksofonët që e mbushnin melodinë me ritme të shfrenuara, atë çast ju bënë sikur klithnin: «Albana, Albana!»

«Ja cila qenka!» — murmuriti me vete. — «U takuam pas kaq vjetësh. Po dhe do të takohemi».

Një ndjenjë plot urrejtje e hakmarrjeje u pasqyrua në fytyrën e tij.

KAPITULLI X

NGJARJE QË NUK HARROHEN

Ato që ndodhën atë mbrëmje në qytetin e vogël kufitar, ngjallën aq shumë interesim te banorët, i bënë ata të ishin më të kujdesshëm, më vigjilentë, për të diktuar çdo gjurmë të armikut, që mund të përfitonte në periudha qetësie, sado të shkurtëra të ishin.

Mbi të gjitha, atyre u bëri përshtypje akti i guximshëm i një vajze të vogël, të quajtur Albana, aq sa banorët krenoheshin me të.

Që në orët e para të pasdites, Albana dhe disa shoqe të saj kishin dalë jashtë qytetit, për të mbledhur sherbel dhe luleshqerra në kodrat rrëzë pyllit.

Koha që e butë dhe e freskët, ashtu siç ndodh rëndom pasditeve të majit. Vajzat qenë shpërndarë të shkujdesura dhe mundoheshin të gjenin vendet ku qenë rritur më shumë luleshqerrat.

Ato nuk kishin ndërmend të qendronin gjatë, sepse së shpejti do të ngrysej.

Albana që shkëputur shumë nga shoqet e saj dhe, si pa e kuptuar, po i afrohej pyllit, ku duhet të kishte shkuar vëllai i saj i vogël për të ushqyer qingjin. Papritmas, rrëzë një kaçubeje pa një lule-

kuqe. Ajo i kishte qejf shumë lulekuqet dhe vendosi të mbledhë një tufë prej tyre. Po ato nuk gjendeshin kaq lehtë. Ndaj filloi të futej thellë pyllit. Mblodhi dhe disa lulekuqe të tjera.

Albana vëzhgonte me kujdes tokën e lagësht dhe pas pak i harroi edhe lulekuqet. Mbi barin e njomë dalloi gjurmë këpucësh, më tutje një bisht cigare të pashuar. Dikush duhet të ishte në pyll. Madje duhet të ishte diku afër. Dësh të kthehej njëherë e të thërriste shoqet. Vetmia në pyllin e heshur e trembi për një çast. Por, po të kthehej, mund të humbiste gjithçka. Të kujt ishin ato gjurmë?

Albana mbajti vesh. Diku, përmes kaçubeve, ju duk se dëgjoi një zë. Pastaj një tjetër.

Po ata ç'ishin?

Eci ngadalë andej nga vinin zërat, duke u mundur të mos shkaktonte as zhurmën më të vogël. Zërat po i vinin gjithmonë e më qartë. Zgjati kokën përmes degëve të dendura të një kaçubeje dhe pa tre burra, që bisedonin kokë më kokë.

Ajo nuk mund t'i dallonte fytyrat e tyre, po zërat i dëgjonte.

Zëri I. — E qartë, pra. Nesër, në orën tetë të mbrëmjes, do të takohemi këtu.

Zëri II. — Nga bie shtegu që do kalojmë?

Zëri I. — Përse interesohesh kaq shumë?

Zëri II. — Ashtu kot, sa për ta ditur.

Zëri I. — Se nga bie, këtë do t'jua tregoj nesër.

Zëri III. — Pse, nuk ke besim te ne?

Zëri I. — Unë nuk kam besim as te vetja ime.

Po ta mësoni, ju do të përpiqeni të ikni qysh sonte. Po për ta gjetur nuk e gjeni dot, se nuk është kaq lehtë. Mund të bini dhe në gjurmët e kufitarëve.

Kështu që duroni deri nesër. Tani duhet të shpërndaheni. Kujdes kur të shkelni mbi bar, se mbeten gjurmë. Të gjitha duhet të zhduken. Të jeni gati për të kryer detyrën, që kemi marrë përsipër.

U ngritën që të tre.

Megjithëse po binte muzgu i mbrëmjes, Albana arriti të shquajë tiparet e fytyrave të tyre. Dhe papritur ajo u drodh. Këtë radhë nuk mundi të përmbajë një klithmë. Midis atyre të treve kish dalluar atë burrin me fytyrë të ashpër, që banonte afër shtëpisë së saj dhe që një ditë, kur po shkante në shkollë, për të marrë pjesë në një ndeshje, i kish folur aq rëndë.

Albana u kthye rrëmbimthi dhe çau përpara përmes degëve të pemëve.

Ashtu si bisha që ndjen erën e gjahut, ata të tre mbajtën një çast vesh. Po kjo zgjati vetëm një çast. Nxorën armët që mbanin në brez, u përkulën, hetuan me sy dhe e pikasën.

— Dikush na ka gjurmuar. Ta kapim pa humbur kohë.

— Hej ti, ndal, ku vete?

Atë çast ata panë një vajzë që vraponte disa metra larg tyre, tutje monopatit që humbiste përmes pyllit.

— Ah, kush na qenka! — tha burri që njohu Albanën.

Tjetri pranë tij ngriti revolverin që mbante në duar, po ai i bëri shenjë ta ulte.

— Po ajo i ka dëgjuar të gjitha! — nguli këmbë tjetri.

— Idiot. Krisma do të na tradhëtojë e atëhere merr fund çdo gjë. Ajo duhet therur. — Si tha këto, nxori thikën dhe u sul drejt Albanës.

Filloi një vrap i çmendur përmes monopatit. Burri me thikë në dorë pandehu se do ta arrinte shpejt Albanën dhe atëhere... atëhere do të merrte fund çdo gjë. Mirëpo ajo dredhonte si kaproll përmes drurëve të pyllit.

Dy të tjerët e ndiqnin nga pas dhe shihnin të tmeruar.

— Mbaruam, — tha njëri prej tyre. Ah, kur nuk e vrava atë çast. Po tani, tani si do të bëjmë? Tjetri dukej i llahtarisur e diç belbëzonte.

Burri me thikë, duke gulçuar, po ndiqte Albanën, si vrapuesit që ndjekin njëri tjetrin. Po largësia midis tyre po shtoej.

Njëri nga ata të dy, një burrë me ca mustaqe, filloi dalngadalë të zmbropsej e papandehur ja mbathi.

Tjetri bri tij u kthye dhe e vështroi me sy të çakëryer.

— Hej, ç'bën kështu? — klithi.

Ai me mustaqe u ndal një çast e, duke shkuar, tha:

— Të ikim, të humbasim gjurmët. Eja dhe ti.

— Qëndro, do të të kapin! — ulëriu tjetri. — Do të na marrësh në qafë. — Dhe si e kuptoi që ai po e linte, i ra pas, po tjetri ish bërë erë përmes pyllit.

Kurse Albana vraponte me një frymë.

Burri me thikë nuk po i ndahej. Pas pak ata dolën nga pylli.

— Ah, e mallkuar! — shfryu ai duke parë që nuk mund ta arrinte.

Në sfond dukej qyteti. Ajo me siguri do t'i tregonte njeriut të parë që do të haste. E ndjeu veten të humbur. Ju duk se po e linin fuqitë. Po

shtrëngoi dhëmbët dhe vendosi të hedhë zarin e fundit. Ngriti dorën, u mat mirë dhe qëlloi drejt Albanës.

Albana, që herëpashere, duke vrapuar, kthente kokën nga pas, u mënjanua, uli kokën dhe thika, me fishkëllimë ngjethëse, u ngul në trungun e një peme.

Burri, i çarmatosur, humbi drejtpeshimin dhe u shemb përtokë.

Albana u zhduk nga sytë e tij.

Ai mezi merrte frymë dhe fytyra i qe mbuluar tërë djersë. Megjithatë u ngrit, u kthye prapa dhe ja nisi përsëri vrapit si i çmendur.

Në të hyrë të pyllit e ndjeu veten më të lehtësuar. Po ku ishin dy shokët e vet? Pikasi njërin prej tyre, që po dridhej i lebetitur.

— Ç'u bë tjetri? — pyeti.

— Ja mbathi.

— Idioti. Do ta kapin.

— Pastaj do të na kapin edhe neve. Aman, s'kemi ç'bëjmë më! Të ikim!

— Po, po, të ikim!

— Po nga është shtegu?

— Eja pas meje!

Ata u sulën përmes pyllit. Tani nuk vraponin dot, sepse degët e pemëve plekseshin e ngatërroreshin keq njëra me tjetrën dhe errësira që po mbulonte pyllin, i pengonte.

Gjatë kësaj kohe, Albana arriti në qytet. Takoi një, takoi dhe një tjetër. Pastaj rreth saj u grumbulluan shumë njerëz, burra, gra, fëmijë dhe ushtarakë. Pa humbur kohë, u sulën drejt korieve që çonin në pyll.

Burri me mustaqe lëvizte përmes degëve të

pemëve, ndërsa dy shokët e tij kishin lënë prapa pyllin dhe po kalonin nëpër shkëmbinjtë.

Tani ishte bërë natë.

Befas njëri nga ata të dy rrëshqiti, u rrëzua duke lëshuar një ulërimë ngjethëse. I pari, që kish ndjekur Albanën, u kthye dhe tha:

— Ç'pate, ç'të ngjau?

— Oh, këmba, këmba e mallkuar, — rënkoj i dyti, pa mundur të mposhtte dhëmbjen.

I pari diç tha nëpër dhëmbë, ju afrua dhe i foli me kërcënim:

— Pusho, mbylle gojën, do të na marrësh më qafë.

— Ndihmomë, të lutem, — mezi arriti të thotë tjetri.

Shoku e ngriti në këmbë. Të dy bënë disa hapa përpara.

— Është dhe shumë larg? — pyeti i dyti.

— Edhe një çerek ore.

— Je i sigurtë se do të arrijmë pa u diktuar?

— Patjetër. Mba veten, bëhu burrë, ndryshe mbaruam. Kufitarët mund të jenë përreth.

— Sikur t'u shpëtonim. Ah, ç'na bëri ajo vajzë!

I pari vazhdonte të mbante shokun e tij që çalonte.

Ndërkohë ishte dhënë alarmi. Njerëzit, me pish-tarë, kandila, rrethonin gjithandej pyllin.

Thirrjet e tyre shponin terrin e natës dhe me një oshëtimë të mbytur arrinin deri te ata të dy që po kalonin mes shkëmbinjve.

— Po këta ç'janë? — pyeti i dyti duke ngritur zërin që dridhej.

— Shët! Janë ata.

— Qenkan shumë pranë.

— Ecë tani!

I pari e shtyu.

— Ecë, të them!

— Oh, nuk mundem.

Po i pari i dha një të shtyrë dhe ai u përplas pas një shkëmbi.

— Ndal i poshtër, ndal, — u çorr ai.

Po më kot, se i pari po humbiste në gjirin e natës.

Mblodhi tërë forcat dhe, pas shumë orvatjesh, u ngrit më këmbë. Bëri një hap përpara, u përpoq të nxirrte revolverin e ta qëllonte, po sakaq humbi drejtpeshimin dhe u rrokullis tëposhtë me një sokëllimë të llahtarshme.

Ndërsa i pari kish humbur në errësi, burri me mustaqe sillej vërdallë si i dalldisur. Atij i dukej se një shteg i verbër do ta shpinte diku, ndoshta përtej kufirit, po papritmas pa një dritë, një tjetër, pastaj një mori dritash e ju bë se i tërë pylli u përflak. Pastaj dëgjoi disa zëra «Këtu, këtu, ja tek është». Atëhere, pa ditur ç'të bënte, ngriti duart lart.

Kufitarë, burra, gra, fëmijë vazhdonin ndjekjen.

Buzë shkëmbinjve, në një hon jo shumë të thellë, ata dalluan një kufomë. Ishte njëri nga ata. Po tjetri? Ai për të cilin kish folur vajza e vogël që ndodhej bashkë me ta. Ai ishte zhdukur.

KAPITULLI XI

DY INTERVISTA TË RADIOKRONISTIT SPORTIV

Radiokronisti sportiv erdhi në fushën, ku do të zhvillohej krosi ndërkombëtar, një ditë para fillimit të tij. Dhe jo pa qëllim. Ai kishte ndërmend t'i kushtonte krosit, edhe në vigjilje të tij, një radiokronikë: të fliste për stërvitjet, itinerarin e garës, për gjëra që do të improvizonte në vend aty për aty e në fund të intervistonte dhe disa nga pjesëmarrësit e ekipeve, që nuk i kishte intervistuar më parë. Do të ishte diçka interesante që radiokronikën e tij ta mbyllte me intervista të tilla.

Mbi shkallët e tribunës si gjithnjë kish pak spektatorë. Më shumë ishin sportistët, shoqëronjësit e ekipeve e specialistë.

Grupet e vajzave, të veshura me tuta sportive, po lëviznin e vraponin në fushën e gjelbër.

Duke parë nga larg, atij i shëmbëllyen si petale lulesh shumëngjyrëshe, që era i hedh andej këndeje.

Radiokronisti sportiv hapi kapakun e manjeto-fonit, shtrëngoi me dorë mikrofonin dhe u përqëndrua. Atij nuk i pëlqente me asnjë mënyrë që, gjatë regjistrimit të radiokronikave, të lexonte ndonjë hyrje apo shënim të parapregatitur. Disa nga kolegët

e tij, që nuk e ndjenin veten të sigurtë, vepronin në atë mënyrë. Ai i përçmonte ata dhe i quante pseudo-radiokronistë. Vetë ishte i ndërgjegjshëm për aftësitë e tij, si një artist i fjalës, ndaj nuk donte të mbante asnjë shënim orientues, nga ata që shpesh janë të domosdoshëm për radiokronistët. Madje, ai e ndjente veten të qetë e të shpenguar, kur i transmetonte radiokronikat drejt e në mikrofon, si domos kur transmetonte ndeshjet e futbollit. Kurse kështu i dukej se radiokronika e regjistruar në manjetofon e lodhte, e bezdiste dhe për më tepër ajo i bëhej pengesë për frymëzimin e tij spontan.

Megjithatë, pa u menduar gjatë, shtypi pulsant e manjetofonit dhe nisi të flasë, duke intonuar zërin e tij të plotë e radiofonik, që tingëllonte pastër.

«Edhe një ditë na ndan nga fillimi i krosit ndërkombëtar. Vetëm një ditë. Një periudhë e shkurtër për ekipet pjesëmarrëse. Po dhe kjo periudhë duhet shfrytëzuar. Ja përse në fushë janë duke u stërvitur pothuaj të tëra ekipet. Në një nga radiokronikat tona të kaluara, duke bërë fjalë për arritjen e ekipeve, ne intervistua disa nga trenerët e tyre. Sot do të bisedojmë me disa të tjerë, për të ditur se cilat ekipe janë pretendente për të zënë vendet e para».

Radiokronisti sportiv fliste shpejt dhe rrjedhshëm.

Pasi tha dhe disa fjalë të tjera, ai plotësoi thjesht, po mirë, hyrjen e radiokronikës. Pastaj shtypi një pulsant tjetër të manjetofonit dhe sakaq shiriti manjetik, që kish thithur pak më parë fjalët e tij, ndaloi.

Për të plotësuar radiokronikën, atij i duhej të

regjistronte të paktën dhe dy intervistat e parashikuara. Po nuk nxitoi. Ai la mënjanë manjefonin dhe drejtoi shikimin në fushë, ku po vazhdonin stërvitjet.

Traineri i huaj diç po u thoshte vajzave të ekipit të tij. Midis tyre binte në sy një vajzë e gjatë me flokë të verdhë, të prerë shkurt.

Pas pak vajzat filluan të vrapojnë në fushë, të prira nga ajo me flokë të verdhë.

Ato po kalonin para tribunës. Vëmendja e të tjerëve qe përqëndruar tani nga ato.

— Më shpejt, më shpejt, — thirri treneri i huaj.

Dhe vajzat filluan të shtojnë shpejtësinë. Në këto e sipër trenerit të huaj ju afrua gazetari:

— Më duket se ajo po vrapon me një ritëm shumë të shpejtë, — tha gazetari, duke ndjekur me sy vajzën me flokë të verdhë.

— S'ka gjë të keqe. Ky është ritmi i saj i natyrshëm.

— Të tërë atë po shikojnë. Madje e admirojnë.

Një valë kënaqësie mbuloi fytyrën e trenerit.

— E përse të mos e admirojnë? Ajo është një talent i rrallë. Jam i lumtur që e kam zbuluar vetë.

— Ndaj krenohesh kështu?

— Kam të drejtë. Në karrierën time si trener kurrë nuk kam patur një atlete si kjo.

— Kjo, ama, nuk duhet të të gëzojë.

— Ashtu është. Për fat të keq, si trener nuk më kanë çmuar sa duhet. Po që kur kjo atlete filloi të ketë sukses, nisën të flasin dhe për mua, dhe është e kuptueshme, sepse emri i sportistit lidhet me trenerin që e stërvit, si emri i një artisti me

regjizorin që ka vënë në skenë një dramë, apo ka realizuar një film.

— Sa të pëlqen të fitosh nam! — e ngacmoi gazetari.

— S'do mend. Mos vallë ty nuk të pëlqen të fitosh nam? Ti gëzohesh kur shkruan një artikull, apo reportazh të bukur, sepse ai do të botohet në gazetë. Njerëzit do ta lexojnë, pastaj do të interesohen të dinë kush e ka shkruar. Ti e fiton namin me mënyrën tënde, unë me timen. Po çështja nuk është të fitosh vetëm nam.

— Po çfarë tjetër?

— Edhe para. Ç'është nami pa para. Një vrimë në ujë. Ti, përshembull, a do të gëzohesh po mos të të paguanin për ato që shkruan, pavarësisht se lexonjësit do t'i pëlqenin shkrimet e tua e ti do të fitoje nam?

— Në asnjë mënyrë.

— Kështu është dhe puna ime. Nami dhe paraja për mua janë të pandara.

— Po ti fiton para?

— Gjer tani, për fat të keq, jo dhe aq sa disa trainerë të tjerë që s'kanë asgjë më tepër se unë. Po që kur më besuan këtë ekip, besoj se e kam rrugën e hapur. Kjo vajzë është një garanci për mua. Sikur edhe atletika e lehtë të konsiderohej si sport profesionist dhe te ne ashtu si futboli!

— Ç'do të thuash?

— Këtë vajzë mund t'ja shisja një klubi të pasur, ose do ta pregatisja mirë, që ta blente ndonjë klub i huaj.

— Do të humbisje një talent.

— Po nga ana tjetër do të fitoja para. Dhe, po të kisha shumë para, do të formoja një ekip të

fortë me yje të mbledhur nga vende të ndryshme dhe do të organizoja gara demonstrative.

— Do të ishte bërë një sipërmarrës i mirë.

— Pa dyshim. Ekipet e mia do të fitonin në shumë gara. Kujto disa ekipe futbollit apo basketbollit në Evropë. Përse janë të forta, përse kanë suksese në aktivitetet ndërkombëtare? Sepse sipërmarrësit kanë para dhe blejnë yjet më të mirë, qofshin në Suedi apo Brazil, — shpjegoi treneri i huaj duke ngritur flokët e kuq që i kishin rënë mbi ballë.

— Ti kot nuk i ke hyrë tregëtisë, i dashur mik, — tha gazetari. — Do të kishe qenë një ekspert i shkëlqyer.

— Ta pret mendja. Po të thashë: është për të ardhur keq që atletika e lehtë është një sport diletant e jo profesionist.

— Ndoshta në të ardhmen do të bëhet.

— Vështirë. Përderisa nuk është bërë në shumë vende të Evropës dhe të botës. Kështu që, nga kjo pikëpamje, mund të më qortosh se nuk po tregohem realist.

Ai desh të shtojë dhe diçka tjetër, po në këto e sipër atyre ju afrua radiokronisti sportiv. Ai shkëmbeu me të disa fjalë sa për t'u njohur, pastaj, duke i zgjatur mikrofonin hyri drejt në temë.

— Ne intervistuaam para pak ditësh disa nga trenerët e ekipeve të tjera dhe u njohëm me opinionet e tyre rreth fituesve të këtij krosi. Do të donim të dinim dhe opinionin tuaj. Çfarë pikësynimi keni në këtë garë?

Traineri i huaj nënqeshi lehtë, mblodhi buzët, duke përkulur pakëz kokën e, pa e zgjatur shumë, tha me një ton të prerë:

- Ne do të zemë vendin e parë.
- Jeni plotësisht i sigurtë në këtë parashikim?
- Plotësisht.
- Ku bazoheni që arrini në këtë përfundim?
- Në ekipin tim bën pjesë një atlete ekstra-klasë. Ja, vështrojeni.

Ai bëri shenjë nga vajza me flokë të verdhë, prapa së cilës po vraponin shoqet e saj.

— Ajo qysh tani ka arritur rezultate të shkëlqyera në garat 400, 800 dhe 1000 metra dhe është e natyrshme që edhe në këtë kros do të manifestojë talentin e saj.

— Po për atletet e tjera?

Traineri mblodhi supat.

— Ato, ç'është e vërteta, nuk kanë rezultate të larta si ajo. Po e përsëris, me një atlete si kjo, unë do të fitoj vendin e parë.

Radiokronisti sportiv mbylli manjetofonin, përshëndeti me kokë dhe u largua.

— Më pëlqen siguria me të cilën u shprehe,
— tha gazetari duke ndezur një cigare, — Po, mos ndoshta u nxitove?

— Nuk të kuptoj, — u habit traineri i huaj.

— Si të them. Ishte e domosdoshme që të shprehje pikësynimin tënd kaq hapur? Të kuptohemi, unë këtu flas nga përvoja vetjake. Një intervistë të tillë unë do ta botoja në gazetën time pa ngurruar. Kuptohet vetvetiu që ky koleg do ta transmetojë me radio dhe të tërë do ta marrin vesh.

— Shumë mirë do të bëjë. Unë enkas fola në këtë mënyrë. Ç'të keqe ka në këtë mes?

— S'ka asnjë të keqe. Po çështja është se ekipi ynë duhet të dalë i pari.

— Dhe ti dyshon për këtë? — tha gazetari dhe kapsalliti sytë.

— Më fal, ti je specialist dhe duhet ta njohësh mirë gjendjen e ekipeve të tjera pjesëmarrëse.

— As duhet të dyshosh për këtë. Unë nuk them fjalë në erë. Madje do të të këshilloja që dhe ti të jepje qysh sot ndonjë korespondencë për gazetën tënde.

— Dhe të shprehja opinionin tënd?

— Fjalë për fjalë, apo «ad literam», siç i thoni ju.

— Ndoshta dhe këtë mund ta bëj, — tha gazetari dhe hodhi sytë nga ana e majtë e tribunës, ku po stërviteshin vajzat shqiptare.

Ato kishin bërë një vrapim të lehtë dhe tani po zhvillonin disa ushtrime me trup të lirë. Pastaj kthyen kokën prapa për të parë atleten e huaj me flokë të verdhë, që, pas një sprinti të fortë, sikur të përfundonte ndonjë garë, po drejtohej nga treneri e gazetari i huaj, duke lënë pas shoqet e saj.

— Atlete e shkëlqyer! — tha Besa, pa mundur të fshehtë druajtjen që po i çfaqej në fytyrë.

— Sidomos sprintin e ka të shkëlqyer, — shtoi Liza.

— Ashtu vërtet, ajo është një atlete e shkëlqyer, po jo e paaritshme, — tha Albana.

Traineri i vërejtí vajzat dhe foli:

— Ke të drejtë, Albana. Dhe unë ashtu mendoj. Mos u ndikoni nga ky vrapim demonstrativ. Tani do të bëni një rrotullim, duke e shtuar shpejtësinë në 200 metrat e fundit.

Vajzat nisën të vrapojnë.

Traineri shtypi pulsantin e kronometrit, për të ndjekur grafikun e vrapimit të vajzave dhe u mat

të bënte përpara, kur befaz vuri re se dikush po i afrohej.

Radiokronisti nuk kishte ndërmend të qendronte gjatë, ndaj, pasi u përshëndosh me trainerin, nxori mikrofonin dhe tha:

— Dhe tani, para se të ndahemi, të dashur dëgjues, shkëmbejmë dhe dy fjalë me trainerin e ekipit shqiptar. Do të doja të dinim cilat janë pikësynimet tuaja në këtë garë. Është një pyetje që ua kemi bërë dhe trainerëve të ekipeve të tjera.

— Parashikimet në sport janë gjithmonë të rrezikshme, sepse sporti është i mbushur plot me të papritura. Megjithatë, mund të them se ekipi ynë do të paraqitet mirë.

— Po më falni, në gjuhën sportive kjo është disi e papërcaktuar, — ndërhyri me delikatesë radiokronisti sportiv.

— Nuk di si t'jua shpjegoj ndryshe. Vetëm mund të përsëris ato që thashë pak më sipër: mendoj se do të paraqitemi mirë.

Radiokronisti sportiv, duke shtrënguar mikrofonin, diç u mundua të thotë, po pastaj, kur pa që treneri shqiptar që shumë i kursyer në fjalë, gjykoi se dhe me kaq ja kish arritur qëllimit, ndaj falenderoi dhe u largua.

DRUAJTJA

Albana dhe Liza vraponin përpara, ndërsa Besa kishte mbetur më pas. Pastaj dalngadalë ajo e uli shpejtësinë dhe ca më pas u ndal e filloi të ecë me kokë ulur.

Traineri i huaj dhe gazetari që ishin ulur në shkallët e para të tribunës, kishin kthyer kokën nga vajzat shqiptare.

— E shikon, njëra prej tyre mbeti, — tha treneri.

— Ç'pati? — pyeti gazetari.

— Do të jetë lodhur, çfarë tjetër. Mungesë përgatitjeje. Mendo se nesër do të zhvillojë dhe garë.

— Mbase nuk e ka nga lodhja.

— Megjithatë ajo ndaloi.

— Sidoqoftë qenkan të shkathta këto vajza. Sidomos ajo që vrapon e para. Ndonëse është pak e shkurtër, ka diçka interesante në vrapimin e saj. Mendoj se sprintin final do ta ketë të shpejtë.

— Hm, s'e ke keq. Dhe ashtu mund të jetë, — tha treneri duke rrudhur ballin. — Po mos u mbështet shumë në këto stërvitje spektakolare. Ne-

sër, në garë, do të shihet se sa do t'i vlejë ky sprint final.

— Këtë gjë mund ta kuptosh ti si specialist. Unë çfaqja vetëm një mendim. Po ja ku po i afrohet asaj vajzës treneri shqiptar.

Besa kishte qendruar.

— Ç'pate, Besa, përse nuk vrapon? — e pyeti ai.

Ajo nuk ju përgjegj. Po një hie shqetësimi i kishte mbuluar fytyrën. Shtrëngonte buzët, si të përmbante diçka.

Albana dhe Liza, kur panë që Besa kishte qendruar, u ndalën dhe deshën të ktheheshin, po treneri u bëri shenjë të vazhdonin stërvitjen.

— Mos je sëmurë? — pyeti përsëri treneri.

— Jo, — tha ajo pas pak. — Po desha t'ju pyes për diçka: s'di si të them, jam e shqetësuar. Si do të dalim në këtë garë?

— Këtë pyetje ma bëri pak më parë një gazetar, — tha treneri.

— Dhe si ju përgjigjët?

— Se do të dalim mirë, Besa. Unë këtë jua kam thënë gjithnjë.

Për një çast ata heshtën.

— Tani të kuptoj. Ti nuk ke besim? — nisi të flasë përsëri treneri.

— Më falni, unë nuk di si ta shpjegoj. Po sot në fushë gjithçka më duket e ftohtë, e huaj.

— Kjo të shqetëson?

Besa pohoi me kokë.

— Është e kuptueshme. Gara ka gjithmonë emozione të forta, sidomos ditët e fundit. Aq më tepër një garë me përgjegjësi si kjo, ku ti dhe shoqet e tua merrni pjesë për herë të parë.

Besa nuk foli.

— Nuk ke besim as te shoqet, as dhe te unë?
Fytyra pakëz e hequr e Besës mori një të kuq të lehtë, po përsëri nuk foli.

— Ti mendon se jemi vetëm në këtë tokë të huaj, Besa. Po nuk është ashtu. Kujto telegramet që na kanë ardhur nga atdheu. Atje na kujtojnë. Me shpirt e me zemër janë me ne. Kjo nuk është pak.

Ai e mori për krahu me butësi.

— Ti duhet të kesh besim te vetja, te shoqet dhe te unë. Kjo ka shumë rëndësi, Besa. Nuk duhet t'i nënçmosh kundërshtarët. Ata janë të fortë, madje mjaft të fortë dhe të përgatitur. Po as nuk duhet t'i mbivlerësosh. Po humbe besimin në vete, ke humbur gjithçka. Kujto se edhe atëhere ti nuk pate besim, po, megjithatë, gjete forca. Dua të të them dhe diçka tjetër: e shikon atë trainerin që po bisedon me atë atleten me flokë të verdhë? Me atë jam ndeshur dikur në pistën e vrapimit. Ai ishte shumë i fortë, siç është e fortë dhe kjo atlete. Megjithatë, ai nuk më kaloi dot dhe kjo sepse unë nuk u tremba, po luftova. Dhe ti kështu duhet të veprosh. Tani shlodhu pak, përqëndrohu. Gjithçka do të kalojë. Ke për të parë.

Besa u ul në barin e butë të fushës. Dukej e menduar.

Traineri u kthye nga Albana dhe Liza që po e prisnin.

KAPITULLI XIII

TREGIMI I TRAINERIT

Unë e di se çfarë mendon ajo tani. Dhe atëhere ndodhi diçka pothuajse si kjo e sotmja. Më patën caktuar të merrem me përgatitjen e një grupi atletesh të reja të Kombinatit të tekstileve. Këtë detyrë e mora me dëshirë, megjithëse nuk ishte dhe aq e lehtë: midis vajzave punëtore, që çdo ditë mbushnin repartet e fabrikave të Kombinatit, duhet të zgjidhja elemente të afta, për t'u marrë me atletikën e lehtë. Siç dashuronin punën, vajzat duhet të dashuronin dhe atletikën e lehtë, sepse, vetëm po të punonin me dashuri dhe pasion, mund të arrinin rezultate të mira.

Unë pata mundësi të zgjidhja disa vajza të shkathta. Midis tyre qenë Besa dhe Vjollca. Kisha besim se ato do të bëheshin atlete të mira. Sidomos Besa.

Po një ditë ngjau një e papritur.

Po zhvilloheshin garat, për t'u zgjedhur atletet, që do të merrnin pjesë në spartakiadën kombëtare të qendrave të punës e të prodhimit. Unë prisja që Besa të dilte mirë. Po merreni me mend habinë time, kur në kthesën e fundit, ajo, jo vetëm e uli shpejtësinë, po e la fare garën, kur pa që atë po e kalonte Vjollca, e cila, duke vrapuar gjithnjë shpejt, arriti e para.

Ndërsa të tërë po përgëzonin Vjollcën, vrapova drejt Besës, që kish mbetur vetëm dhe gati po shpërthente në lot.

— Përse e le garën përgjysmë? — e pyeta.

— Nuk mund të vrapoja më. E ndjeja se po më linin fuqitë, — m'u përgjegj ajo, pa më shikuar në fytyrë.

— Ti u nxitove, Besa. Duhet ta kishe përfunduar garën me çdo kusht. Dhe, po të kishe mobilizuar tërë forcat, them se do të kishe dalë mirë. Dëgjomë mua: ti i ke këto aftësi. Po s'ka gjë, në garat e tjera do ta kesh parasysh këtë, — i shpjegova unë.

— Nuk do të vrapoj më. Nuk dua të merrem më me sport.

Këto fjalë ajo i tha me ton të prerë e të vendosur, e me një theks nervozizmi.

Të them të vërtetën, kjo përgjigje më habiti.

— Ç'do të thuash, Besa? — e pyeta.

— Kot ngulni këmbë. Ju e patë vetë se ç'ndodhi sot. Unë nuk do të bëhem kurrë atlete e mirë.

— Gabohesh, Besa, ti mund të dilje e para. Unë për këtë isha i bindur. Vetëm se duhet t'i ruaje forcat dhe t'i përdorje si duhet, — ngula këmbë unë.

Drejt nesh po vinte Vjollca, që, siç duket, i kish dëgjuar fjalët e mia të fundit.

— Vërtet, Besa. Kurrë nuk do të ma merrte mendja se ti do ta lije garën përgjysmë, — i tha ajo.

— Ti nuk duhet të shqetësohesh, sepse dole e para, — e ndërpreu pa u përmbajtur Besa.

— Besa! — e qortova.

Mirëpo ajo më ndërpreu me këmbëngulje:

— Nuk do të vrapoj më! — Dhe u largua e pezmatuar.

Ne mbetëm të stepur.

— Më duket se e ka humbur besimin në vete, — tha Vjollca.

— Kështu më duket dhe mua, — ju përgjigja. — Kjo është e rrezikshme për një sportiste. Ç'është më e keqja, ne pasnesër kemi dhe garat e spartakiadës. Po s'ka gjë, në garën e 800 metrave do të marrësh pjesë ti.

— Po Besa? — pyeti me habi e kureshtje ajo.

— Ajo duhet të fitojë besimin. Dhe kjo s'është e lehtë.

Spartakiada u zhvillua në stadium. Shkallët e tij qenë mbushur nga shumë spektatorë, midis të cilëve kishte shumë punëtorë tekstilistë. Garat e atletikës do të fillonin pak më vonë, prandaj ne po ndiqnim një ndeshje basketbolli, që skuadra e Kombinatit po zhvillonte me një tjetër në një nga anekset e stadiumit. Midis një grupi shoqesh vura re Besën. Ajo dukej e zymtë. Vjollca ende nuk kishte ardhur.

Loja qe tepër e gjallë dhe na kish mbërthyer. Herë shënonte skuadra jonë dhe herë tjetra. Ne duartrokisnim. Duartrokiste dhe Besa. Po dukej se nuk ishte e gëzuar. Megjithatë do të kalonin disa ditë e ajo do ta kuptonte gabimin që kish bërë. Çështja ish që ta mbaja afër.

Isha zhytur në këto mendime, kur papritur u kujtova dhe vështrova orën. Vjollca nuk po dukej.

U ngrita dhe nisa ta kërkoj.

— Mos e kini parë Vjollcën? — pyeta disa që kisha pranë.

— Jo, s'e kemi parë! — u përgjegj një nga të rinjtë.

Fillova të shqetësohesha.

Ndërkohë ndeshja e basketbollit kish përfunduar. Skuadra jonë kish fituar. Djem e vajza tani po drejtoheshin nga tribuna, ku do të zhvillohej gara e 800 metrave.

Unë endesha nëpër fushë duke shikuar herë orën, herë në fushë, për të pikasur Vjollcën që nuk dukej gjëkundi.

Ju afrova shkallëve të stadiumit, pa ditur ç'të bëja.

— Ndeshjen e basketbollit e fituam. Tani do të fitojmë dhe garat e atletikës. Edhe garën e 800 metrave do ta fitojmë. Vjollca fluturon, — tha njeri.

— Po ku është Vjollca? — pyeti një vajzë.

Ato hodhën vështrimin në fushë.

— Si s'paska ardhur! — tha djaloshi.

Në këto e sipër njëri nga gjyqtarët m'u afrova dhe më tha:

— Ju nuk keni paraqitur pjesëmarrësen në garën e 800 metrave.

— Tani, — ju përgjegja pa ditur dhe vetë ç'të bëja.

Nja dy-tri vajza e djem u shkëputën nga tribuna dhe m'u afrovan.

— Ende s'ka ardhur, — më tha djaloshi, me të cilin kisha biseduar pak më parë.

— Diçka duhet t'i ketë ngjarë, — i thashë duke vështruar orën. — Me siguri kështu duhet të jetë.

— Sikur ta lajmëronim.

— Tani është tepër vonë. Ajo e ka shtëpinë në periferi të qytetit.

Nga altoparlanti u dëgjua zëri i folësit: «Pjesëmarrësit e garës së 800 metrave të paraqiten pranë gjyqtarisë».

Unë e humba durimin.

— Sa keq që ndodhi kështu, — thashë. — Po të mos zemë vend të mirë në këtë garë, mund të rrezikohemi në klasifikimin e përgjithshëm të spartakiadës.

Megjithatë duhej gjetur një rrugëdalje. Një vajzë, cilado që të ishte, duhej të paraqitej në garë.

U mendova disa çaste, pastaj ju drejtova djaloshit:

— S'kemi ç'bëjmë. Lajmëro Verën të vijë këtu.

— Do të marrë pjesë ajo? — pyeti njëra nga vajzat aty pranë.

Unë pohova me kokë.

Djaloshi u largua duke vrapuar.

Po i afrohesha gjyqtarisë, duke vrarë mendjen se cila mund të ishte arësyeja që Vjollca s'kish mundur të vinte, kur papritur pashë Besën që, duke vrapuar, më tha me një frymë:

— Ju lutem, më regjistroni mua!

Çdo gjë mund të prisja, po kurrë një gjë të tillë. Një shprehje vendosmërie lexohej në fytyrën e saj.

— Të lumtë, Besa! — i thashë. — Bëhu gati shpejt! — Dhe shkova drejt gjyqtarisë, për të regjistruar emrin e saj.

Sigurisht që kur panë Besën në pistën e vrapimit, të tërë u habitën. Dhe kishin të drejtë. Pas pak do të fillonte gara.

Besa ju afrua korsisë së parë.

Ajo u përkul dhe mbështeti duart në tokë. Për një çast qendroi dhe mori frymë thellë. Unë u afrova dhe qendrova anës korsisë, disa metra larg saj.

Besa ngriti kokën dhe vështrimet tona u kryqëzuan. Fytyra e saj pak e mprehtë kishte një

pamje të vendosur. I buzëqesha dhe i bëra shenjë me dorë të ishte e qetë. Dhe ajo më buzëqeshi.

Pastaj filloi gara plot britma dhe emocione.

U ktheva dhe u drejtova te shkalla e parë e stadiumit për ta ndjekur më afër garën.

— Përpara, Besa, edhe pak, edhe pak, — thërrisnin djemtë e vajzat e Kombinatit. Besa po vraponte me hap të sigurtë. Ajo ishte shkëputur dhe po arrinte e para.

Shokët dhe shoqet e Besës po duartrokisnin. Fillova dhe unë të duartrokas.

Besa, shend e verë, duke hapur krahët vrapoi drejt meje dhe më përqafoi:

— Më fal, — thoshte ajo, — paskam qenë e gabuar.

Papritur, përballë nesh u duk Vjollca.

— Ku humbe kështu, Vjollcë? Çfarë ngjau? — e pyeta me një ton disi të prerë.

Po ajo, pa u përgjigjur, u sul drejt Besës dhe i tha:

— Të lumtë, Besa! Kot nuk ke patur besim në vete. A nuk të kam thënë se ti gjithnjë do të dalësh mirë?

Ato u përqaftuan.

Doemos, unë mezi prisja të dija ç'i kish ndodhur Vjollcës. Po nuk pata rast të pyes, sepse në fushë u derdhën djem e vajza për të përgëzuar Besën.

Më së fundi gjeta rast dhe pyeta Vjollcën.

— Po thuamë ç'të ndodhi? Përse u vonove?

Ajo mbeti si e zënë në faj. Buzëqeshja ju tret në fytyrë dhe tregoi krahun e lidhur që e kishte djegur disa orë më parë.

KAPITULLI XIV

BUZËQESHJET E MBRËMJES

Fusha kish filluar të zbrazej, kur ato lanë stërvitjen. Dhe tribuna qe boshatisur. Vetëm tek-tuk disa njerëz po merreshin me rregullimet e fundit të fushës, ku të nesërmen do të zhvillohej krosi ndërkombëtar.

— Sot mjaft me kaq, — tha treneri.

Besa qe ngritur më këmbë. Ajo pa që Albana dhe Liza ju afruan dhe e morën në mes tyre. Të tria së bashku u drejtuan nga autobuzi që priste në xhade.

Ecën pa folur asnjë fjalë. Besa ndjente shtrëngimin e fortë të krahëve të shoqeve të saj. Ajo e kuptonte se ky shtrëngim nuk ishte i rastit, se kishte një domethënie në ato çaste.

Megjithatë, ajo nuk foli asnjë fjalë. Madje, në ato çaste, ajo nuk dinte ç'të fliste. Priste që shoqet të nisin një bisedë, çfardo bisede, mjaft të thyhej heshtja.

Hipën në autobuz.

— Moj vajza, më duket se paskemi ngelur vetëm ne! — tha Liza, kur vuri re se autobuzi qe boshatisur.

— Ashtu vërtet, — u çudit Albana.

— Jemi më qetë kështu, — tha treneri.

Megjithatë, ata nuk mbetën vetëm. Pas pak, në autobus u futën dhe disa sportistë të tjerë.

Shoferi, pasi thithi disa herë cigaren që mban-te në duar, e hodhi tej, i dha gaz motorit dhe autobuzi rrëshqiti në rrugën e asfaltuar.

Ato soditnin qiellin e përflakur, fushat e ble-ruara përreth. Secila dukej e zhytur në botën e vet.

— A ju ra në sy diçka sot? — pyeti papritur Albana.

Vajzat ngritën supet.

— Nuk kini vënë re këto ditë një burrë me syza, që s'ka munguar në stërvitjet tona?

— Vërtet ashtu! Edhe mua më ka rënë në sy, — tha Liza.

— Është një turist anglez, — shpjegoi treneri.

— Sot, pra, nuk kishte ardhur, — tha Albana.

— Ç'rëndësi ka, tha Liza.

— Asnjë rëndësi, po m'u duk se vëmendjen vazhdimisht e kish pasur të përqendruar te ne. Si shpjegohet? — pyeti Albana.

— E mira është që mos ta vrisni mendjen fare për të, — tha treneri.

Autobuzi bëri një kthesë dhe filloi të shkasë teposhtë. U bë përsëri heshtje. Besa nuk kish thënë qoftë dhe gjysmë fjale.

— E përse të mos ja marrim një kënge? — tha treneri. — Apo jo, Besa?

Besës i ndriti fytyra.

— E përse jo? — ja ktheu ajo.

— Të marrim «Marshin e vraponjësve», — tha Albana.

Dhe nisi të këndojë e para. Atë e ndoqën edhe të tjerët.

*Vrapo si shigjetë,
drejt finishit vrapo,
si zog krahëlehtë
ritmin shpejto...*

Shoferi indiferent ktheu kokën. Edhe ata që
ndodheshin në autobuz kthyen kokën.

*Rekordit të vjetër
pak jetë i ka mbetur,
ndaj vrapo me furi,
t'i sjellësh atdheut
një rekord të ri.*

Vazhdonin të këndonin ata në kor.

Këndonte dhe Besa e buzëqeshte, duke i parë në
sy shoqet e saj. Dhe ato i buzëqeshnin.

Atë mbrëmje, autobuzi dukej se mbarte këngë,
optimizëm dhe buzëqeshje.

ËNDËRRA TË PERËNDUARA

Ishte dita e fundit para garës.

Mister Bllejbërgu i kish ndjekur vajzat gjatë këtyre ditëve si hie, po kurrë nuk i kish parë të ndaheshin njëra nga tjetra. Edhe kur ishin ndarë, kjo kish ndodhur brenda një kohe të shkurtër, në vende që binin në sy, te shkallët, në holl, pranë banjës, në koridor, ku nga çasti në çast mund të kalonin njerëz.

Nëse ditët e para nuk e kish ndjerë veten të shqetësuar, i bindur se do të krijoheshin rrethana në të cilat do ta kryente misionin e tij, tani, ditët e fundit, e pushtoi një pasiguri e hutim, dhe i shëmbëllente vetja si i dënuari që pret me ankth orën e ekzekutimit.

Ndonjë nga të arratisurit e tjerë, agjent si ai, do ta humbiste pusullën e do të dështonte. Po kjo nuk do të ndodhte kurrë me të, vetëm duhej të kish durim. Gjendja nuk ishte dhe aq alarmante, sa për të humbur besimin, sepse, në fund të fundit, ai kishte dhe një gur për të hedhur: Albana flinte vetëm në dhomë. Vajzat, ç'është e vërteta, mbidheshin herë në njërën dhe herë në tjetrën nga dho-

mat që ndodheshin kundruall njëra tjetrës. Po pasdreke ato ndaheshin për të pushuar. Pasdreke, pra, do të futej në dhomën e Albanës. Ai mund ta vinte planin në jetë edhe natën, po jo, nuk duhej të humbiste kohë.

Paradite ai i pa vajzat që hipën në autobuzin pranë stacionit të hotelit. Traineri nuk ishte me to. Pra, ato nuk po shkonin në stërvitje. Aq më mirë për të. Për ku vallë qenë nisur? Siç duket bënin ndonjë shetitje. S'kish si të ndodhte ndryshe.

U fut në maqinë dhe nisi të ndjekë autobuzin. Vëzhgonte me kujdes ata që hipnin e zbrisnin, që vajzat të mos i shpëtonin nga sytë.

Në stacionin e tretë i pa tek zbritën. Aty pranë ngrihej një magazinë me vitrina të mëdha luksoze.

«Ah, tani e kuptova. Ato kanë ardhur të blenë ndonjë send. Po ç'para mund të kenë ato të gjora! Po, nejse, jam kureshtar të di se ç'do të blenë», mendoi me vete. «Mbase Albana mund të shkëputet në këtë mori njerëzish».

Tri vajzat u futën në magazinë. Mister Bllejbergu qendronte larg tyre. Sido që njerëzit vërshonin grupe-grupe, ai s'e kishte të vështirë t'i shquante: ato binin në sy nga pjesa e sipërme e tutave sportive, që kishin ngjyrë të kuqe.

Pas ca kohe, tri vajzat dolën nga magazina me nga një pako kujtimesh në duar. Pastaj qendruan te stacioni i autobuzit. Siç duket do të ktheheshin përsëri në hotel.

Mister Bllejbergu nxitoi në një nga repartet e magazinës. Kur po dilte nga magazina, vajzat po hipnin në autobuzin që mori përpara drejt rrugës që të shpinte në hotel. Kurse ai qetë-qetë u fut

në maqinën e tij dhe këtë radhë i dha me tërë shpejtësinë, duke kaluar autobuzin që çante përmes vargut të dendur të maqinave.

Arriti në hotel shumë më përpara se vajzat.

Pas disa minutash ai ishte ngjitur në katin ku ato flinin dhe diç po bisedonte në një kënd me një nga shërbyesit, të cilin ishte përpjekur ta afronte gjatë atyre ditëve.

Ai po e dëgjonte me vëmendje.

Tri vajzat arritën më vonë. Ato u ngjitën sipër të ndjekura nga vështrimi i shërbyesit. U takuan me trenerin dhe i treguan dhuratat që kishin blerë. Kjo bisedë zgjati shumë pak dhe ato u futën në dhomën e Albanës.

Traineri zbriti poshtë.

U desh të paktën një orë që tri vajzat të dilnin nga dhoma. Ato po kalonin nëpër koridor për të zbritur poshtë. Në hollin që ishte i shkretë, mister Bllejbërgu ecte lart e poshtë, si njeri që pret diçka.

Befas nëpër shkallë pa shërbyesin me të cilin kishte biseduar. Ky, si zbriti disa shkallë dhe vëzhgoi përreth, ja bëri lehtë me kokë, Mister Bllejbërgu u ngjit sipër. Shërbyesi ecte disa hapa para tij.

Duke u ngjitur në shkallët e katit të tretë, ai pa të tria vajzat. Mister Bllejbërgu qendroi një hop, ndezi një cigare dhe, duke marrë pamjen e njeriut të shkujdesur, ndaloi gjoja të vështronte disa kuadro të varura në muret e koridorit.

Atij i kish mbetur vetëm një gur për të hedhur.

Dhe ai do ta hidhte. Vërtet ishte punë e rrezikshme, po nuk kish si të vepronte ndryshe.

Tri vajzat kishin zbritur poshtë në restorant, ku i priste treneri i tyre.

Dhe, si zakonisht, ata biseduan, qeshën, thua se rreth tyre nuk kishte njeri tjetër.

Mister Bllejbërgu bisedoi përsëri me shërbyesin. Diç e porqësi atë. Pastaj, ngaqë nuk kishte oreks, shkoi në banak ku piu një dopio fërnet. Alkooli veproi si një stimulant në nervat e tija të tendosura. Ju duk se e mori përsëri veten. Po kjo qe e përkohshme.

Ju bë sikur po dridhej. Madje dhe duart po i dridheshin tek po ndizte një cigare.

Nga altoparlanti i radios gjëmonin tingujt e shfrenuar të një muzike dhe zëri i një këngëtari që ulurinte. Atij i dukej se këngëtari po ngërdheshje e po qeshte me të.

Kjo ja ngriti nervat. I shkuan mornica në trup. Ç'po ndodhte kështu me të. Mos ndoshta ajo që kishte ndodhur me ata agjentë që kishin dashur të takoheshin e të ballafaqoheshin me shqiptarët, po që kurrë nuk ja kishin arritur qëllimit?

Mos e kishte kapur edhe atë frika e paniku?

«Kurrë, kurrë» murmuriti me vete dhe rrëkëlleu dhe një dopio fërnet tjetër.

Vajzat dhe treneri u ngritën dhe u ngjitën sipër. Ai pas tyre. Që të tria hynë në dhomën e Albanës, ndërsa treneri u fut në dhomën e tij.

Priti disa minuta, që ju dukën të gjata, shumë të gjata. Po sikur ato dy të tjerat të qendronin tërë mbasditen në dhomën e Albanës?

Priti edhe disa minuta të tjera. Kur po e humbiste durimin, i pa që dolën nga dhoma e saj dhe u futën në dhomën kundruall. Bëri disa hapa përpara me shpejtësi, pa ditur as vetë se ku shkonte. Lart e poshtë koridorit, ndonëse rrallë, lëviznin njerëz. Dëgjoi çelësin që u rrotullua në bravë.

Ahere bëri edhe disa hapa të tjera. Heshtje. Po sikur ndonjë nga vajzat të kujtohej për diçka e të vinte sërishmi në dhomën e Albanës? Po sikur të vinte treneri? Sikur të ndodhte, kur ai të mos kishte hyrë brenda, nuk do të ishte ndonjë e keqe e madhe. Po sikur...

«Në djall të venë këto mendime!» — tha me vete.

Ai ndodhej pranë dhomës së saj. Nga ana tjetër e koridorit pa shërbyesin. Ai ishte një memec i bindur, që i kryente me përlësi detyrat që i kish ngarkuar, domosdo, pasi e kishte paguar mirë. Kish kryer dhe detyrën e fundit. Lidhja telefonike e dhomës së Albanës qe prerë.

Ai përsëri ja bëri shenjë me kokë. Pra, nga ana tjetër e koridorit nuk kishte njeri.

Ishte çasti për të vepruar.

U kthye dhe bëri drejt dhomës së Albanës.

Ai shtrëngoi nofullat, shtrëngoi edhe çelësin special që mbante në duar, me të cilin mund të hapte cilëndo derë. E nxori me rrëmbim dhe, me dorën që i dridhej. Çelësi i gjatë dhe i mprehtë u fut pa vështirësi në vrimën e ngushtë të bravës. E rrotulloi lehtë, pa bërë zhurmë, dhe u fut brenda.

Sytë e tij të mprehtë përfshinë brenda sekondës tërë dhomën: shtratin, tryezën, pasqyrën. Po Albanën nuk e pa. Mos kish gabuar, mos ndoshta nuk ishte aty. Shtrati dukej i paprekur.

Automatikisht mbylli derën me çelës.

Atëhere pa Albanën të hynte nga ballkoni në dhomë. Vështrimet e tyre u kryqëzuan. Albana që kish soditur pamjen e qytetit në ballkon, nuk kish ndjerë asgjë e, duke u futur në dhomë, e ndodhur përballë një të huaji, nuk e përmbajti dot një britmë habie.

Për disa çaste mbetën pa folur. Po vetëm për disa çaste. Pas këtij hutimi të shpejtë, Albana e mori veten. Duhet të kishte një keqkuptim. I huaji duhet të kishte gabuar dhomën. Ajo u zbut në fytyrë dhe nisi të shpjegojë anglisht:

— Më falni, po në këtë dhomë fle unë!

— E di, e di që fle ti në këtë dhomë, ndaj edhe kam ardhur, — ju përgjegj pa ngurruar shqip e gjithë mllëf mister Bllejbërgu.

— Çfarë? — u habit Albana dhe kapsalliti sytë. — Ju dini shqip?

— Unë jam shqiptar, — ja ktheu ai, duke e mbajtur me vështirësi urrejtjen që i ziente përbrenda.

— Përse erdhët këtu?

— Për t'u takuar me ty, — i tha duke kërcëllitur dhëmbët.

— Kush jeni ju? Nga më njihni?

— Të njoh prej shumë vjetësh, që kur ke qenë e vogël, tepër e vogël. Po ty nuk të kujtohet?

— Jo, nuk mbaj mend. Po kush jeni ju?

— Kujto vite të shkuara fqinj tënd, atë që të ndoqi atëhere në pyll.

— Si, ti je ai?

— Po, ai vetë. Ti po më shikon gjithnjë e më me habi. Habitesh që kam ndryshuar hë! Vërtet, shumë kam ndryshuar? Jam shëndoshur, kam veshur rroba të bukura. Kam dhe më të bukura. E, mbi të gjitha, kam dhe para.

— Ç'do nga unë? — pyeti Albana dhe u vrejt në fytyrë.

— Mos mendon se dua të hakmerrem? Fitimi që mund të kem nga ti është më i madh. Dikur të kam urreyer, sepse ti desh më more më qafë. Po që atëhere ka kaluar shumë kohë. Ti je një

sportiste e mirë. Të pret një e ardhme e shkëlqyer.
— Kurse me vete thoshte: «Ajo po zbehet. Apo më duket mua. Mos është indinjuar? Apo mos po tërhiqet nga fjalët e mia».

— Jam e lumtur që ja kam arritur kësaj.

— Jo, ti nuk ja ke arritur, po do t'ja arrish. Vetëm jo në Shqipëri. Ti atje do të mbarosh shpejt?

— Ç'kërkon të thuash?

— Dëgjomë me vëmendje. Të mos humbasim kohë. Eja me mua. Do të bëhesh e pasur. Eja në Perëndim. Ti atje do të bëhesh e dëgjuar. Do të fitosh lavdi, para, më kupton, para me thasë! Kurse në Shqipëri, gjykoje vetë ç'të pret atje. Sa të paguajnë?

«Ajo po hesht. Tani po afrohet. Fjalët e mia po e tërheqin. Po përse është ashtu e zbehur? Duket shumë e pavendosur. Po duhet shkuar më përpara».

— Hë pra, thuamë! Sa të paguajnë? Asnjë dhjetësh, e di mirë unë. Kurse atje, me një kontratë, siguron jetën. E kupton ti ç'do të thotë me një kontratë të sigurosh jetën? Shikomë mua si kam ndryshuar. Dhe xhepin e kam plot me para. Ja shikoi vetë: në kuletë kam njëqind, dyqind, pesëqind dollarë. Edhe ti do të kesh shumë. Dhe këto do t'i sigurojnë këmbët e tua të arta. Përse nuk flet?

«Vërtet, përse nuk flet? Mos habitet nga paratë. Ajo nuk ka parë kurrë dollarë!»

— Mos u druaj. Eja të ikim. E kemi shumë lehtë. Mjafton të zbresim shkallët e prapme, ku është maqina ime. Asnjë prej shoqeve nuk ka për të kuptuar gjë. As edhe ka për të të parë. Po edhe po të pa... Ti je e lirë të vepros si të duash. As-

një nuk mund të të pengojë. Eja. Vetëm atje mund të bëhesh sportiste e dëgjuar.

«Ajo po afrohet. Po tani po i dridhen buzët. Po ç'pat kështu? Përse i shtrëngon dhëmbët, përse më vështron ashtu?..»

Nuk pat kohë të mendonte gjatë, sepse papritur Albana i shfryu:

— Tradhëtar i ndyrë! Për këtë punë paske ardhur? Pandeh se ne shitemi me para si ti? Ke gabuar rrugë, ti, kërmë e zgjebosur, që krekosesh me dollarët e tu të krimbur. Unë jam e pasur dhe e lumtur, sepse mbroj ngjyrat e atdheut. Po ti s'mund ta kuptosh këtë, kurrë s'mund ta kuptosh, sepse ti nuk ke atdhe.

Atij i hipi gjaku në kokë, po e mbajti veten. Albana nxitoi te telefoni.

— Është e kotë, telefoni nuk punon.

— Këtë di të bësh ti me shokët e tu. Tani shporru andej nga ke ardhur!

Mister Bllejbërgu u zbardh në fytyrë. Kjo përgjigje i dogji më shumë se një shuplakë. Buzët ju drodhën. Ai zgjati dorën dhe preku revolverin që mbante në xhepin e xhaketës. Aty kishte dhe një thikë, si ajo me të cilën kish qëlluar dikur Albanën.

Po mbeti. Mekanikisht mblodhi dorën. Ç'mund të bënte? Ta qëllonte me plumb, me thikë, atëhere vajza do të klithte, klithma do të ishte vdekje për të. Nga dhoma do të dilnin vajzat e tjera shqiptare dhe treneri i tyre.

Albana qëndronte para tij e ftohtë, si një statujë e mermertë, e vrejtur, gati t'i hidhej në fyt.

— Jashtë, jashtë, — bërtiti Albana dhe rrëmbeu një vazo që ndodhej në tryezë.

«Ajo duhet vërrarë. Po atë nuk e trembka vde-

kja, s'duhet humbur asnjë minutë» mendoj ai. Po nuk guxoi të bënte gjë. Padronët ja kishin ndaluar një veprim të tillë.

Ai hapi derën me rrëmbim dhe u sul përmes koridorit, ndërsa nga pas e ndoqi zëri i Albanës që i thërriste:

— Shporru, frikacak i ndyrë!

Kjo thirrje buçiti me forcë nëpër koridorin e heshtur, ku u derdhën treneri dhe vajzat e tjera, që dukeshin të shqetësuara.

— Ç'është kështu, Albana? — pyeti treneri. — Ç'ndodhi? Kush është ai që po vrapon? Turisti anglez!

— Ai nuk është turist anglez, — tha Albana, e zbehur në fytyrë, — po një i arratisur!

— I arratisur?

— Ç'kërkonte?

— Që unë të shkoja në Perëndim, sepse vetëm atje mund të bëhesha sportiste e shkëlqyer!

Përmes dritares së gjerë të koridorit ata panë maqinën e të arratisurit që çau përpara dhe humbi në bulevardin plot zhurmë.

KAPITULLI XVI

FITORJA

Tribuna e spektatorëve po mbushej dalngadalë. Gjyqtarët, të veshur me të bardha, po zinin vendet e tyre. Disa po bënin regjistrimin e pjesëmarrësve të krosit ndërkombëtar, të tjerë qendronin në shkallët, pranë finishit të garës.

Në stolat, poshtë shkallëve të tribunës, kishin zënë vend specialistë, gazetarë, vëzhgonjës sportivë. Aty u ul gazetari dhe treneri i huaj.

Atletët në fushë po bënin përgatitjet e fundit para garës.

— Harrova të të them, — nisi të flasë gazetari, — mbrëmë dhashë në telefon një korespondencë për gazetën time.

— Kjo më gëzon pa masë, — tha treneri i huaj.

— Midis të tjerave, theksova pjesëmarrësit e krosit, vendin e garës.

— Vetëm kaq? — e ndërpreu treneri.

— Në fund shtova dhe intervistën që i dhe radiokronistit sportiv.

Trainerit të huaj i ndriti fytyra.

— Vetëm të mos na ndodhë ndonjë e papritur, — tha gazetari.

— Të jesh i sigurtë, i dashur mik, se asgjë nuk do të ndodhë. Çdo gjë do të përfundojë sipas parashikimit tim.

Nga ana e djathtë e tribunës, pranë finishit, erdhën tingujt e një marshi.

Ca më tutje dukej radiokronisti sportiv. Këtë radhë nuk e kishte marrë me vete manjetofonin portativ. Ai nuk i duhej, sepse gara do të transmetohej drejtpërsëdrejti me radio. Po kjo nuk e shqetësonte. Atij i pëlqente që po ndodhte kështu, sepse tani do të komunikonte menjëherë me dëgjonjësit. E vërteta ish se ky transmetim do të ishte i shkurtër. Shumë-shumë do të zgjaste, me gjithë hyrjet dhe komentet e intervistat, rreth pesëmbëdhjetë, njëzet minuta. Zakonisht radiokronika të tilla ai i quante të lehta. Për të ato ishin një farë shkrythje, ku vështirë se mund të jepte me temperament atë që donte. Ndryshe ishte në ndeshjet e futbollit, se aty lidhej me emocionet dhe të papriturat që krijojnë vetë loja. Nga kjo pikëpamje, krosi i dukej një garë e zbetë, pa ngjyra. Çfarë do të mund t'u jepte dëgjonjësve? Po më tepër e preokuponte çështja se a do ta pëlqenin atë vetë, kur ta dëgjonin, a do t'i dëgjonte me veshët e tij në mbrëmje, kur të shkonte në kafenenë, ku zakonisht kalonte mbrëmjet, komplimentat e kolegëve dhe të admiruesve të tij. Apo kjo ngjarje sportive, e dhënë nëpërmjet gojës së tij, do të kalonte në heshtje?

Megjithatë, ishte i bindur se do t'ja delte në krye. Ai e kishte aftësinë e improvizimit. Kjo ishte kryesorja. Në qoftë se gara nuk do të paraqiste ndonjë interesim të veçantë, do të ishte ai që ta krijonte këtë, sepse, në fund të fundit, të gjithë

dëgjonjësit ishin të varur nga fjala e tij. Përderisa ishte kështu, ai s'do t'i linte të mërzitëshin, po do t'i shtonte, do t'i improvizonte situatat nëpërmjet dridhjeve të zërit. Për këto ishte i përkryer. Sa herë i kishte rastisur në ndeshjet e futbollit një gjë e tillë. Ndokush këtë mund ta quante falsifikim, një shtrembërim të asaj që po ndodhte. Po atij aq i bënte, në qoftë se kishte njerëz që shpreheshin kështu. Puna ishte që të tjerët ta lëvdonin. Kështu do të ndodhte dhe në këtë garë. Aq më tepër po të fitonte ekipi i vendit të tij.

Në këto e sipër, atij i dhanë shenjën dhe, pa humbur kohë, nisi të flasë: «Dhe ja, tani jemi para fillimit të krosit ndërkombëtar. Atletet pjesëmarrëse po bëjnë përgatitjet e fundit. Koha dhe fusha e mirë, e favorizojnë zhvillimin e garës...»

Trainerët u ishin afruar pjesëmarrësve dhe po u jepnin porositë e fundit. Pranë tri vajzave shqiptare qendronte treneri i tyre. Ai u thoshte:

— Kështu pra, pas pak, vetëm pas pak do të fillojë gara. Duhet të keni kujdes. Mos u shkëpusni njëra nga tjetra. Mos u shqetësoni po qe se atletet kundërshtarë mund të jenë para jush. Duhet të vraponi sipas grafikut tonë. Sprintin do ta filloni vetëm nga fundi i garës.

Ai i shikoi me butësi dhe u rrahu shpatullat.

Traineri dhe gazetari i huaj kishin kthyer kokën nga ata.

— E shikoni, si po u jep atyre porositë e fundit, — tha treneri i huaj.

— Ashtu si do t'u japësh edhe ti. Kjo është e kuptueshme dhe e natyrshme për ju trainerët, — ju përgjegj gazetari.

— Kjo është vërtet e kuptueshme, kur e di që do të zësh një vend të mirë.

— Megjithatë, mua më habit një fakt: radio-kronisti sportiv e intervistoi atë dhe...

— Ju gazetarët vetëm sensacione kërkon. Së fundi, përse të mos dëgjonte dhe mendimin e tij? — e ndërpreu treneri i huaj.

— Po e di që ai i tha se ekipi shqiptar do të dalë mirë?

— Vërtet? Kjo më habit. Ky është besim i tepruar.

Pa pritur përgjegje, treneri i huaj u ngrit dhe ju afrua vajzave të ekipit të tij.

— Ti duhet të shkëputesh përpara, — i tha ai vajzës me flokë të prerë shkurt. — Gjithnjë sa më përpara.

— Po shoqet e tjera? — pyeti ajo.

— Ato le të të ndjekin. Suksesi i garës varet nga ti. Ti duhet të realizosh një kohë sa më të mirë. Do të dalësh e para, do të sigurosh një sukses të bujshëm: shtypi, radioja, televizioni për ty do të flasin. Më kupton?... Po të veprosh ti mirë, edhe shoqet e tua ashtu do të bëjnë.

Vajza buzëqeshi me krenari.

— Dhe ju të dyja, mundohuni ta ndiqni, — vazhdoi ai duke ju drejtuar ftohtë vajzave të tjera.

Pastaj ai hodhi sytë nga e majta dhe pa trenerin shqiptar që po vazhdonte të bisedonte me vajzat.

— Suksesi i garës varet nga ju të tria, — u tha treneri shqiptar. — Kjo është garë ekipore dhe jo individuale. Mos mendoni për vete, po për ekipin, atdheun që përfaqësoni në këtë kros ndër-

kombëtar. Kini besim dhe luftoni një për të gjithë dhe të gjithë për një.

Ai u shtrëngoi duart vajzave që u larguan, për t'u rreshtuar pranë kufirit të startit.

Pastaj, siç ndodh në të tilla raste, u bë heshtje. Vëmendja e të gjithëve u përqëndrua në fushë. U dëgjua krisma e pistoletës dhe vajzat u turrën me vrap, si një tufë zogjsh të trembur.

— Filloi, — tha treneri shqiptar dhe vështroi shigjetën e zezë të kronometrit.

— Filloi, — tha treneri i huaj me flokë të kuqe, duke ju drejtuar gazetarit.

Radiokronisti sportiv e përqëndroi vëmendjen te zhvillimi i garës.

Traineri shqiptar e përqëndroi shikimin te Albana, Liza dhe Besa, që vraponin së bashku. Traineri i huaj i hodhi sytë andej nga fillimi i grupit, ku printe vajza e gjatë e veshur me të bardha.

— E shikoni, ajo u shkëput që tani, — tha pastaj duke marrë një pamje krenare. — Me një vraponjëse të tillë mund të fitosh edhe në kampionatin evropian.

— Optimizmi yt më qetëson, — u përgjegj gazetari.

— Kam arësye. Ajo është zbulimi im. Shiko ç'të dhëna fizike ka! Ç'hap elegant!

— Vërtet ashtu është. Po dy të tjerat, ama...

— E, ke hak. Dy të tjerat janë ca të ngadalshme. Po ç'rëndësi ka? Ajo do t'u shkëputet shumë kundërshtareve, do të dalë e para. Ato pastaj do të nxiten dhe do ta shtojnë ritmin. I kam llogaritur të tëra. Kështu do të ndodhë. Kush mendoni ju se do ta kalojë?

Gazetari ngriti supet, po nuk u përgjegj. Ai po

ndiqte me sy grupin e ngjeshur të vajzave, që tani po zvargej e hollohej përmes lëndinës së gjelbër, si një shirit i larmë.

«Mirë po shkon», — tha me vete. — «Mirë e ka ky, s'ka si të ndodhë ndryshe».

«Mirë», — tha me vete dhe treneri shqiptar. — «Ato po vrapojnë si duhet».

Dhe ato vraponin pranë e pranë. Albana u printe dhe ato pas... «Albana ki kujdes. Mos u shkëput shumë përpara. Ka ende kohë. Kjo është garë ekipore dhe jo individuale. Mos mendo për vete, po për ekipin: një për të gjithë e të gjithë për një. E kupton, Albana?»

Asaj i dilte përpara fytyra e shqetësuar e trenerit me kronometrën në duar.

«Mos u shqetësoni. Ashtu po vrapoj».

Për krah saj vraponin kundërshtarët e huaja.

Tani po i ngjiteshin kodrës. Gara po vështirësohej. Ajo ngjitej dhe sillte ndërmend kodrat dhe plepat pranë stadiumit, ku kishin zhvilluar stërvitjet e përsëri i dilte përpara fytyra e trenerit.

«Duhet të përgatitemi mirë. Kundërshtarët tona janë shumë të forta».

Pas saj vraponin Liza dhe Besa.

«S'duhet t'i ndahemi Albanës», — mendonte Liza.

«Jo, nuk duhet t'i ndahemi», — mendonte dhe Besa.

Ato të tria ishin njohur në pistën e vrapimit, kishin dalë të parat e tani të tria, të pandara, po vraponin krah për krah njëra tjetrës në atë vend, qindra e qindra kilometra larg atdheut.

Tani radiokronisti sportiv e kish përqendruar vëmendjen te vajza me flokë të verdhë, që po dil-

te e para. Vajzat e ekipit të vendit të tij s'duke-shin gjëkund. Ai s'kish ç't'u bënte, prandaj që të kish sukses në atë radiokronikë, duhej të tregohej i gjallë, i zhdërvjelltë. Kjo kish tani rëndësi.

Vraponte vajza e huaj e veshur me të bardha. Vraponte e para, e linte pas shiritin e larmë të kundërshtareve e tringëllonin në vesh fjalët e trainerit: «Shkëputu sa më shumë përpara; Lavdia do të të përkasë vetëm ty».

«Lavdia!.. Vërtet që do të më përkasë mua. Emri im do të mbushë faqet e gazetave. Edhe fotografia ime. Të dal e para».

— Po, po, e para po del. Shikojeni sa shumë po shkëputet. Nuk ju thashë, ajo është një talent i vërtetë, — tha traineri i huaj, duke treguar me gisht vajzën e veshur me të bardha, që tani kish filluar të bënte rrotullimin për të ardhur drejt finishit.

— Mirëpo ku janë vraponjëset e tjera të ekipit? — pyeti me pa durim gazetari.

— Mos u shqetësoni. Diku aty janë. Jam kurreshtar të di se ç'bën traineri shqiptar. Ah, ja tek genka! — dhe traineri i huaj bëri shenjë anës rreshtave të spektatorëve.

Traineri shqiptar shikonte kronometrën, pastaj ngulte shikimin drejt grupit të vajzave që po afrohej.

«Tani duhet filluar shkëputja, tani, Albana, pa humbur kohë!»

«Po, po, tani!»

Albana kujtoi porosinë e trainerit, shikoi shpinën e bardhë të vrapueses që po zhdukej mes gjelbërimeve dhe shpinat e kundërshtareve të tjera që kishte përbri, e u shkëput duke zgjatur hapin.

«Liza, Besa, më dëgjoni?»

«Po, Albana, të dëgjojmë».

«Erdhi koha. Përpara!»

Shiriti i larmë filloi të zgjatej më shumë. Vende-vende ngjeshej e dredhonte më shpejt përmes lëndinës së gjelbër, si ta çante e tejshkonte.

— Ç'po ngjet kështu? — tha gazetari. — Shiko atë shqiptaren, sa shpejt po vrapon tani.

— Sado të vrapojë, nuk do të dalë e para, — u përgjegj treneri.

— Mirëpo ajo po i afrohet shumë asaj sonës. Pastaj, shiko dhe vajzat e tjera shqiptare. Ti the që ato do të mbeten nga fundi, kurse ato po përparojnë. Po tonat ku janë?

— Të thashë të mos shqetësohesh. Shikoni!

Gazetari e vështroi i habitur.

— Mos u çmende? Si është e mundur ti, trener, të flasësh në këtë mënyrë. Mos vallë harrove sa pak rëndësi ka nëse ajo do të dalë e para? Çështja është të dalë i pari ekipi ynë, — tha pastaj me inat.

Traineri i hodhi një vështrim të turbullt.

— Megjithatë, ajo do të dalë e para, — përsëriti duke zvaritur fjalët.

— Hajvan! — briti gazetari, duke flakur tej cigaren që mbante në dorë.

«Po të tjerat, ç'u bënë? Megjithatë, ajo do të dalë e para. Ajo është zbulimi im, merita ime. Do të më sigurojë dhe mua lavdi. Gjithnjë e para do të dalë».

«Po, po, e para do të dal».

Vajza me flokë të verdhë solli ndërmend fjalët e trenerit të vet, premtimet e tija, famën, të gjitha i solli ndërmend.

«Ç'u bënë ato, ku janë? E ç'rëndësi ka se ku janë. Nëse nuk del ekipi ynë i pari, unë do të dal e para».

— E çuditshme, — thoshte radiokronisti sportiv, duke shtrënguar mikrofonin. Pikërisht tani që nuk pritej, vajzat shqiptare po kalojnë përpara. Madje njëra prej tyre është ndër të parat.

Traineri shqiptar tani qe ngritur më këmbë. Turmat e spektatorëve pranë finishit mezi përmbaheshin.

— Ajo me flokë të verdhë po del e para.

— Nuk ka rëndësi në del e para. Shoqet e ekipit të saj janë larg.

— Po cili ekip do të dalë i pari?

— Me ç'po duket, ai i vajzave shqiptare.

— Si është e mundur?!

Kështu bisedonin njëri me tjetrin gazetarë e spektatorë.

Athletet, duke gulçuar, me fytyra të dirsura e të lodhura, po i afroheshin finishit.

«Ju lumtë, vajza! Edhe pak, dhe do të jesh në vendin e parë». — Më dëgjon, Albana?

Traineri shqiptar nuk u përmbajt dhe fjalët e fundit i tha me zë të lartë.

«Të dëgjoj, të dëgjoj. Liza, Besa, edhe më shpejt».

«Mos u shqetëso, Albana. Shpejt po vrapojmë!...»
Dhe të tri vajzat çanin përpara.

— Ç'bëre, hajvan! Ç'trainer qenke ti? Na humbe vendin e parë!

Traineri i huaj mbeti i shastisur e u skuq, ndërsa fytyra e gazetarit të huaj dukej e xhindosur.

Vajza me flokë të verdhë arriti e para. Ajo buzëqeshi, priti të vinin fotoreporterët, radiokronis-

ti, po asnjëri nuk e vuri re. Ju afrua trainerit dhe përgjegjësit të ekipit. Priti se mos ata i thoshin ndonjë fjalë, ta përgëzonin, po u habit kur i pa të nemitur.

«Sidoqoftë, unë dola e para! — tha me vete dhe i vështroi me përçmim, duke ndjerë ta pushtojë një ndjenjë vetëkënaqësie.

Po e zgjuan nga kjo dehje disa brohoritje e duartrokitje. Ato qenë të pakta, po pastaj u dëgjuan në të gjithë fushën. Ktheu kokën dhe pa tri vajzat shqiptare, që përqafoheshin me trainerin e tyre dhe pjesëtarët e tjerë të delegacionit shqiptar.

«Ah, ja përse u gëzokan! Paskan dalë të parat!» — tha me vete.

Ajo ndjeu një zemërim të çmendur kur pa që fotokorespondentët po i rrethonin me aparatet e tyre. Ktheu kokën nga spektatorët dhe vuri re gazetarin që po ikte, duke e lënë të shushatur trainerin e saj.

«Aq më bën, — tha kur pa dhe dy shoqet e saja të ekipit që ecnin kokulur, si të mbanin mbi shpatulla peshën e disfatës. — Unë dola e para».

Po mbi shkallën e lartë të podiumit u ngjitën tri vajzat shqiptare.

— E papritura më e madhe e krosit, — tha me zë të zvarritur radiokronisti, duke fshirë ballin e djersitur. — Ekipi shqiptar i përmbysi të tëra parashikimet. Ai zuri vendin e parë, duke lënë pas ekipet e tjera, që ishin të sigurta se do të fitonin...

U dëgjua hymni kombëtar i Shqipërisë, ndërsa flamuri i kuq me shqipen dy krenare me yll të kuq po ngrihej si lëmsh i zjarrtë në kaltërsinë e qiellit.

Albana solli ndërmend qytetin e vogël, relie-

vin e dallgëzuar, ku kish nisur të vraponte për herë të parë.

Besa kujtoi stadiumin ku ish stërvitur aq shumë, dhe ndjeu më tepër se kurrë se kish flakur druajtjen njëherë e përgjithmonë.

Ndërsa Liza fshatin e lindjes, të jatin që aq shumë ish trembur se mos vajza po e koriste duke u marrë me sport.

Të tria u bashkuan, ndërsa buçiste hymni kombëtar. Atyre u dukej se tingujt e tij kapërcenin fusha e male e fluturonin atje, në Shqipëri, duke mbartur me vete lajmin e fitores.

PËRMBAJTJA

	Faqe
Kapitulli I — Në tokën e huaj	3
Kapitulli II — Mister Bllejbërgu	9
Kapitulli III — Tregimi i Lizës	13
Kapitulli IV — Duke kujtuar ngjarje të së kaluarës	22
Kapitulli V — Në fushë	33
Kapitulli VI — Kush është mister Bllejbërgu?	37
Kapitulli VII — Vazhdimi i një bisede	43
Kapitulli VIII — Historia e fotografisë	52
Kapitulli IX — Mister Bllejbërgu nuk ka gabuar	67
Kapitulli X — Ngjarje që nuk harrohen	71
Kapitulli XI — Dy intervista të radiokronistit spor- tiv	78
Kapitulli XII — Druajtja	86
Kapitulli XIII — Tregimi i trenerit	89
Kapitulli XIV — Buzëqeshjet e mbrëmjes	95
Kapitulli XV — Endërra të perënduara	98
Kapitulli XVI — Fitorja	107